



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË, 2014



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT

Këshilli redaktues:

Redaktori gjuhësor:

Shtypshkronja

ISBN



Vendimi



Fjala e Ministrit



PËRMBAJTJA

Vendimi.....	3
Fjala e Ministrit.....	4
Hyrje	7
Nevojat për ndryshime kurrikulare	9
1 Roli dhe funksioni i Kornizës Kurrikulare	11
1.1 Qëllimet e arsimit parauniversitar	11
2 Kompetencat kyçe për nxënien gjatë gjithë jetës	13
2.1 Përshkrimi i kompetencave kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënit	15
2.1.1 Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	15
2.1.2 Kompetenca e të menduarit	16
2.1.3 Kompetenca e të mësuarit për të nxënë	17
2.1.4 Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	18
2.1.5 Kompetenca personale.....	19
2.1.6 Kompetenca qytetare	20
2.1.7 Kompetenca digjitale.....	20
3 Parimet e përgjithshme të zhvillimit të kurrikulës.....	22
4 Nivelet e arsimit parauniversitar, shkallët e kurrikulës dhe roli i tyre në organizimin dhe vlerësimin e procesit mësimor-edukativ në shkollë.....	25
4.1 Struktura e arsimit parauniversitar. Veçoritë e niveleve arsimore dhe ndikimi i tyre në kurrikul	26
4.1.1 Arsimi parashkollor.....	26
4.1.2 Klasa përgatitore.....	27
4.1.3 Arsimi fillor (Klasa I-V).....	27
4.1.4 Arsimi i mesëm i ulët.....	27
4.1.5 Arsimi i mesëm i lartë.....	28
4.2 Shkallët e kurrikulës dhe roli i tyre në organizimin dhe vlerësimin e procesit mësimor dhe edukativ në shkollë.....	29
4.2.1 Shkalla përgatitore: Edukimi në fëmijërinë e hershme	30
4.2.2 Shkalla e parë: Përvetësim i bazave për njohje	31
4.2.3 Shkalla e dytë: Përforsim i bazave dhe zhvillim	32



4.2.4	Shkalla e tretë: Zhvillim i mëtejshëm i bazave dhe orientim	32
4.2.5	Shkalla e katërt: Përforsim i arritjeve dhe orientim në karrierë	33
4.2.6	Shkalla e pestë: Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional	33
4.2.7	Shkalla gjashtë: Konsolidim i arritjeve dhe specializim	34
5	Fushat e të nxënit dhe lëndët mësimore.....	35
5.1	Gjuhët dhe komunikimi.....	35
5.2	Matematikë.....	36
5.3	Shkencat e natyrës	37
5.4	Shoqëria dhe mjedisi	38
5.5	Arte.....	39
5.6	Edukim fizik, sporte dhe shëndet	40
5.7	Teknologji dhe TIK.....	41
5.8	Shpërndarja e kohës mësimore për fushat e të nxënit	42
6	Mësimdhënia dhe të nxënit efektiv	44
7	Vlerësimi	46
7.1	Sistemet e vlerësimit	48
7.1.1	Vlerësimi i brendshëm.....	48
7.1.2	Vlerësimi i jashtëm.....	50
8	Dokumentet kurrikulare.....	51
8.1	Kurrikula bërthamë	51
8.2	Plani mësimor dhe programet sipas lëndëve	52
8.3	Udhëzuesit kurrikularë	53
	Fjalorth i terminologjisë kurrikulare	54



Hyrje

Kurrikula kuptohet si sistemi i përbërë nga disa elemente me synime arsimore që, të lidhura mes tyre, mundësojnë të orientohet dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula bazohet në realitete historike, shoqërore, gjuhësore, politike, fetare, gjeografike dhe kulturore të një vendi. Me anë të saj sigurohet arsimimi cilësor dhe i barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore dhe ndryshime të tjera.

Në kurrikul, ndër të tjera, përcaktohet se çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë si duhet nxënësit, cilat vlera dhe qëndrime duhen kultivuar, si duhen aftësuar ata për bashkëjetesë e tolerancë, si mund të japin ndihmesë në mënyrë aktive për mirëqenien shoqërore dhe vetjake etj.

Me ndryshimet që ndodhin në shoqëri, shfaqen nevoja të reja, marrëdhënie të reja në shoqëri dhe në tregun e punës, risi teknologjike, aspirata të reja njerëzore, strategji të reja për zhvillim etj. Këtyre ndryshimeve, arsimit duhet t'u përgjigjet me ritme të shpejta, me zhvillime të brendshme sasiore e cilësore, për të mundësuar njohuri të reja, shkathtësi, vlera dhe qëndrime të përshtatshme, sistematike, koherente dhe në zhvillim të përhershëm.

Në këto kushte, nevoja për ndryshime kurrikulare që synojnë kompetencat, rishfaqet gjithnjë e më shpesh si domosdoshmëri në fushën e politikave arsimore dhe praktikën shkollore, ndaj përbën thelbin e reformave arsimore, në përgjithësi dhe atyre kurrikulare, në veçanti.

Në morinë e ndryshimeve të shumta e të shpejta, sasiore e cilësore në të gjitha fushat e jetës, vendi ynë aktualisht po kristalizon edhe përmbajtjen e reformës kurrikulare, si një ndër drejtimet kryesore të kësaj reforme.

Reforma jonë kurrikulare merr parasysh:

- nevojat, zhvillimet e sotme dhe qëllimet e sistemit arsimor, të shpallura në dokumentet e ndryshme të politikave arsimore;
- traditën e sistemit tonë arsimor, që është bazë për vazhdimin e reformës;
- nevojën për rritjen e cilësisë së arsimit dhe trajnimit;



- nevojën për të garantuar mundësi të barabarta për arsimim dhe trajnim cilësor për të gjithë;
- hapjen e sistemit arsimor ndaj botës.



Nevojat për ndryshime kurrikulare

Ndryshimet që kanë ndodhur, të para edhe në kontekstin shkollor, kushtëzojnë edhe drejtimet kryesore të zhvillimeve arsimore, në përgjithësi dhe të ndryshimeve kurrikulare, në veçanti.

Ndërtimi i shoqërisë së dijes

Sot, dija konsiderohet kapitali më i rëndësishëm për të gjeneruar ide të reja dhe të arritur mirëqenie. Ritmet e shtimit të saj janë shumë të shpejta. Shkolla mundëson mbërritjen vetëm tek një pjesë e vogël e informacionit, ndaj ajo duhet t'i ndihmojë të rinjtë dhe të rejtat që krahas kompetencave të përgjithshme për jetë dhe punë, të zhvillojnë edhe kompetencat e duhura për qasjen ndaj informacionit dhe përpunimin e tij në mënyrë të pavarur.

Për shkollën tonë ka shumë rëndësi të përcaktojë se mbi çfarë baze do të zgjidhet përmbajtja e asaj që duhet të mësohet, si do të përzgjidhet ajo që është e rëndësishme nga bota e madhe e informacionit, por dhe si do të realizohet strukturimi i njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për një qëllim të caktuar. Aftësia për të dalluar dijet e domosdoshme për shkollën kërkon vazhdimisht qëndrime kritike ndaj këtyre dijeve.

Nga ana tjetër, shkolla duhet t'i drejtojë nxënësit drejt zhvillimit të aftësive për të zgjidhur problemet dhe situatat praktike.

Rrugët e mënyrat me të cilat njerëzit sot i qasen informacionit dhe shërbimeve ndryshojnë vazhdimisht. Për këtë arsye, të gjitha moshat kanë nevojë të pajisen me kompetenca të reja që i ndihmojnë të zotërojnë botën e sotme digjitale.

Integrimi në epokën digjitale

Shoqëria e dijes po zhvillohet gradualisht në një epokë të re digjitale, mjaft sfiduese. Për t'u integruar në një ekonomi digjitale, nxënësve u nevojiten kompetenca digjitale. Sistemi arsimor duhet të synojë alfabetizimin digjital, në mënyrë që të arrijë shkallën e alfabetizimit të plotë funksional. Njohuritë dhe shkathtësitë digjitale nuk mjaftojnë për të krijuar personalitete komplekse për epokën digjitale, sepse forcën kryesore të botës digjitale e përbëjnë njerëzit dhe vlerat themelore që ata shfaqin.

Rritja e ndërvarësisë dhe e lëvizshmërisë



Ndërvarësia dhe lëvizshmëria, gjithnjë e në rritje, janë bërë tipare dalluese të kohës së sotme. Të gjitha vendet sot janë gjithnjë e më të ndërvarura në fushën e komunikimit, të kapitalit, të arsimit, të kulturës, të migrimit, të stilit të jetesës etj. Zhvillimet e reja në tregun e punës kërkojnë sigurimin e parakushteve për lëvizje dhe konkurrencë të suksesshme të të rinjve në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Të rinjtë duhet të jenë në gjendje t'u përshtaten ndryshimeve të shpejta dhe të paparashikuara, si: kriza ekonomike dhe financiare, përhapja e sëmundjeve ngjitëse, konfliktet e vazhdueshme etj.

Ndërvarësia dhe lëvizshmëria sfidojnë edhe arsimin, nga i cili kërkohen ndryshime të shpejta në përgjigje të këtyre kërkesave.

Ndryshimet në konceptimet për procesin e të nxënësve

Konceptimet bashkëkohore për procesin e të nxënësve theksojnë rolin aktiv të nxënësve në zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave. Nxënësit duhet të jenë veprimtarë aktivë në procesin e ndërtimit, zbatimit dhe vlerësimit të tyre. Vetëm kështu, njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet do të organizohen në struktura që mundësojnë përdorimin e tyre. Kjo kërkon edhe ndryshimin e rolit të mësuesve që duhet të jenë, gjithnjë e më shumë, drejtues dhe krijues të situatave të të nxënësve.

Rritja e rolit të komunitetit

Çështjet që lidhen me cilësinë e shkollës dhe të arsimit janë thelbësore dhe në interes të të gjithë shoqërisë. Nga ana tjetër, shkolla nuk mund të realizojë si duhet misionin e saj pa bashkëpunimin dhe partneritetin e vazhdueshëm me komunitetin në të cilin ndodhet. Për këtë arsye, shkolla duhet të zhvillohet si një qendër shumëplanëshe, që ofron shërbime arsimore cilësore, në bashkëpunim me komunitetin dhe në shërbim të tij.

Zhvillimi i qëndrueshëm

Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, në të cilën cilësia e jetës në Tokë për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm është e kërcënuar, nxënësve u nevojiten njohuri, shkathtësi dhe qëndrime për t'u kujdesur me përgjegjësi për mjedisin natyror dhe atë që ka krijuar e do të krijojë dora e njeriut dhe për të mënjanuar shpërdorimin e burimeve dhe praktikave të papërgjegjshme. Kjo kërkon që të rejat dhe të rinjtë të ndërgjegjësohen se si të luftohen në mënyrë efektive: varfëria, marginalizimi, diskriminimi dhe padrejtësia.



1 Roli dhe funksioni i Kornizës Kurrikulare

Reforma kurrikulare e arsimit parauniversitar, nga pikëpamja e dokumentacionit, bazohet në një sërë dokumentesh shtetërore të cilat pasqyrojnë politikat dhe strategjitë e zhvillimeve arsimore për të ardhmen. Ndër to, dokumenti më i rëndësishëm është Korniza Kurrikulare në të cilën përshkruhen orientimet dhe udhëzimet kryesore për qëllimet arsimore, brendinë, mënyrat e nxënies dhe arritjet e nxënësve. Si dokument kyç për organizimin e sistemit arsimor, Korniza orienton aktorët arsimorë dhe palët e interesuara për aspektet kryesore të kurrikulës, si bazë për të siguruar në mënyrë efektive arsimin cilësor për të gjithë.

Korniza Kurrikulare përcakton:

- qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar;
- kompetencat kyçe që do të fitohen nga të gjithë nxënësit pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë;
- parimet e përgjithshme që orientojnë zhvillimin dhe zbatimin kurrikulës;
- veçoritë e niveleve të arsimit parauniversitar nga këndvështrimin e reformës kurrikulare;
- shkallët e kurrikulës dhe rolin e tyre në organizimin dhe vlerësimin e procesit të të nxënies;
- fushat e të nxënies dhe lëndët, sipas niveleve dhe shkallëve të kurrikulës, si dhe kohën mësimore për çdo fushë;
- mësimdhënien dhe të nxënies e efektshëm;
- sistemin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve;
- dokumentet kurrikulare.

1.1 Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;



- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes.
- përdorin teknologjitë e reja.

Qëllimet e përgjithshme të arsimit shtjellohen dhe konkretizohen më tej në rezultatet e pritshme të të nxënësve, në përmbajtjet mësimore dhe në kulturën e përditshme të shkollës. Realizimi i tyre është detyrë e të gjitha institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë të procesit të arsimimit dhe edukimit.



2 Kompetencat kyçe për nxënien gjatë gjithë jetës

Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit.

Zhvillimet e sipërpërmendura dhe nevojat për ndryshime arsimore e bëjnë të qartë domosdoshmërinë për të nxënë gjatë gjithë jetës. Qytetarëve të shoqërisë së dijes u nevojitet të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet vetjake, shoqërore dhe ato që lidhen me botën e punës dhe tregun e lirë. Procesi i arsimit do t'i mundësojë çdo nxënës zotërimin e kompetencave kyçe, të nevojshme për jetën dhe punën.

Rrugët dhe mënyrat me të cilat njerëzit i qasen sot informacionit dhe shërbimeve ndryshojnë vazhdimisht. Për këtë arsye, të gjitha moshat kanë nevojë të pajisen me kompetenca të reja që i ndihmojnë të përshtaten në botën e sotme digjitale, jo vetëm nëpërmjet fitimit të njohurive dhe aftësive teknike, por edhe nëpërmjet të kuptuarit të thellë të mundësive, sfidave dhe çështjeve etike, ligjore dhe shoqërore që lindin ose shoqërojnë zhvillimet e reja ekonomike, shoqërore dhe teknologjike.

Këto ndryshime shtrojnë domosdoshmërinë e zotërimit të kompetencave që i aftësojnë individët të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja.

Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
2. Kompetenca e të menduarit;
3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
5. Kompetenca personale;
6. Kompetenca qytetare.
7. Kompetenca digjitale



Në tabelë shprehen kompetencat kyçe të zërthyerë në nënkompetenca

KOMPETENCAT KYÇE	
1.	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
	<i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive.</i>
	<ul style="list-style-type: none">○ Komunikon në gjuhën amtare.○ Komunikon në gjuhë të huaja.○ Shprehet me anë të simboleve, kodeve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.○ Komunikon nëpërmjet teknologjive të informacionit.○ Përkushtohet dhe kontribuon për dialog konstruktiv.○ Respekton rregullat e komunikimit.○ Shpreh tolerancë dhe empati në komunikim.○ Komunikon në mënyrë konstruktive.
2.	Kompetenca e të menduarit
	<i>Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.</i>
	<ul style="list-style-type: none">○ Analizon, sintetizon, gjykon, vlerëson, interpreton, krijon dhe mbron qëndrimin e tij të pavarur etj.○ Merr vendime në bazë të informacioneve të plota e të verifikuara.○ Lidh vendimet me pasojat.○ Vlerëson dhe vetëvlerësohet.○ Zgjidh probleme.○ Zotëron kompetencat në fushat kryesore të dijes (matematikë, shkencë natyrore e shoqërore, teknologji etj.).○ Zotëron kompetencat digjitale.
3.	Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
	<i>Nxënësi mëson për të nxënë.</i>
	<ul style="list-style-type: none">○ Identifikon dhe shfrytëzon strategji dhe teknika të të nxënit.○ Zotëron si duhet leximin, shkrimin, matematikën, shkencën dhe TIK-un.○ Identifikon dhe përpunon informacione në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.○ Mëson dhe shkëmben përvoja pozitive në grup.
4.	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
	<i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.</i>
	<ul style="list-style-type: none">○ Paraqet mirë vetveten, duke vënë theksin në pikat e forta.○ Punon në mënyrë të pavarur dhe në grup.○ Organizon dhe udhëheq veprimtari të të nxënit dhe shoqërore.○ Demonstron shkathtësi sipërmarrëse, njohuri për planifikimin e punës dhe për shfrytëzimin racional të kohës.



	<ul style="list-style-type: none"> ○ Zotëron aftësi për menaxhimin e konflikteve dhe vlerësimin e rreziqeve. ○ Ndërmerr veprime të pavarura dhe të përgjegjshme. ○ Merr pjesë në mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.
5.	Kompetenca personale
	<i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme.</i>
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Shfaq vetëbesim. ○ Menaxhon emocionet dhe stresin. ○ Ndiemon dhe shfaq empati për të tjerët. ○ Demonstron aftësi për të bërë jetë të shëndetshme. ○ Bën zgjedhje të përgjegjshme për shëndetin vetjak.
6.	Kompetenca qytetare
	<i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i>
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ndërton marrëdhënie me të tjerët, me shoqërinë dhe me kulturat e tjera. ○ Mirëkupton dhe respekton dallimet ndërmjet njerëzve. ○ Pranon dhe respekton të tjerët. ○ Demonstron përgjegjësi për çështje të interesit të përgjithshëm publik. ○ Merr pjesë në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme në çështje të interesit publik. ○ Përkrah dhe nxit ndryshime të dobishme për jetën vetjake, për shoqërinë dhe për mjedisin.
7.	Kompetenca digjitale
	<i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i>
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Përdor disa aplikacione si: word, spreadsheets, databaza etj. ○ Mbledh dhe përpunon informacionin që gjëndet nga interneti apo komunikimi elektronik. ○ Vlerëson rreziqet që vijnë nga interneti apo komunikimi elektronik. ○ Gjykon për vërtetësinë e informacionit dhe për parimet etike dhe ligjore në përdorimin interaktiv të TIK-ut. ○ Përdor TIK-un për të zhvilluar mendimin kritik dhe krijues. ○ Identifikon, analizon dhe përdor sistemet aplikative për zgjidhjen e problemeve.

2.1 Përshkrimi i kompetencave kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënës

2.1.1 Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Me qëllim që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillojnë personalitetin, të nxënë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë mesazhet që u drejtohen dhe të shprehin në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave



artistike. Për t'u bërë komunikues efektivë, nxënësit ndihmohen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit, e shprehur nëpërmjet rezultateve të të nxënit

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit:

- komunikojnë dhe shprehen me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave dhe kodeve;
- flasin, dëgjojnë, lexojnë dhe shkruajnë në gjuhën amtare dhe në (së paku) një gjuhë tjetër të huaj;
- përfshihen dhe kontribuojnë në dialog të respektueshëm dhe produktiv;
- japin dhe marrin informacion në mënyrë konstruktive dhe krijuese;
- respektojnë rregullat e përgjithshme të komunikimit/ndërveprimit dhe njëkohësisht dhe janë krijues;
- përdorin TIK-un dhe mediat në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme si mjete të rëndësishme të informimit, të komunikimit dhe të ndërveprimit në epokën digjitale.

2.1.2 Kompetenca e të menduarit

Marrja dhe përpunimi i njohurive në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, por edhe për të marrë vendime dhe për të zgjidhur probleme. Duke mbajtur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë thelbësore për shekullin XXI. Nxënësit kanë nevojë jo vetëm që të marrin informacion, por edhe të zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.

Kompetenca e të menduarit, e shprehur nëpërmjet rezultateve të të nxënit

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit:

- identifikojnë, lokalizojnë dhe përdorin informacionin e duhur;
- përpunojnë në mënyrë kritike informacionin (analizojnë, sintetizojnë, organizojnë, shfrytëzojnë dhe zbatojnë);
- zbatojnë hapat për zgjidhjen e problemit;
- gjykojnë drejt, në bazë të analizës dhe sintezës paraprake të fakteve e situatave;
- ilustrojnë me mjete konkrete të menduarit abstrakt;



- vlerësojnë mundësitë e ndryshme dhe marrin vendime të drejta;
- lidhin në mënyrë të përgjegjshme vendimet e tyre me pasojat;
- vlerësojnë cilësinë, rëndësinë dhe vlerën e informacionit, kundrejt qëllimit për të cilin nevojitet ky informacion;
- vlerësojnë paraqitjen vetjake përkundrejt rezultateve të pritshme;
- menaxhojnë informacionin në mënyrë kritike, krijuese dhe të përgjegjshme;
- zgjidhin problemet në nivelin e caktuar të vështirësisë.

2.1.3 Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Në zhvillimet bashkëkohore në shoqëri, në shkencë, në teknologji e në ekonomi nuk mund të kërkohet që të gjitha njohuritë, shkathtësitë e qëndrimet e nevojshme të arrihen nëpërmjet shkollimit. Prandaj, shkolla u krijon nxënësve të gjitha kushtet dhe mundësitë për t'u arsimuar dhe përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Shkolla i ndihmon fëmijët dhe të rinjtë të kultivojnë kërkueshmërinë dhe interesin për dije dhe të zhvillojnë kompetencën për të nxënë. Në funksion të kësaj kompetence, shkolla duhet të ndërtojë njohuritë për rëndësinë e stileve dhe strategjive efektive të të nxënit.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë, e shprehur nëpërmjet rezultateve të të nxënit

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit:

- vlerësojnë nevojën për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- demonstrojnë shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, matematikë, shkenca, TIK dhe në situatat e jetës së përditshme;
- identifikojnë stilet e strategjitë e parapëlqyera të të nxënit;
- ndërtojnë njohuritë e reja mbi njohuritë e tyre të mëparshme;
- vendosin përparësi në qëllimet e të nxënit;
- ndjekin përparimin e tyre dhe bëjnë ndërhyrjet e domosdoshme për t'u përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme;
- janë më të motivuar për të nxënit e mëtejshëm;
- shfrytëzojnë teknologjinë për të nxënë;



- kërkojnë dhe shfrytëzojnë këshillat, informacionin dhe ndihmën, kur është e nevojshme;
- ndërmarrin nisma, vlerësojnë rreziqet dhe përballen me vështirësi gjatë nxënies;
- menaxhojnë në mënyrë produktive dhe të përgjegjshme burimet që kanë në përdorim;
- bashkëpunojnë me të tjerët, menaxhojnë konfliktet;
- veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme;
- vlerësojnë në mënyrë kritike punën e tyre duke iu referuar qëllimeve fillestare.

2.1.4 Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Shkollat përgatitin nxënësit për të jetuar, për të punuar në një botë të ndërlikuar dhe për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI, kërkon kompetenca për t'u përballur me rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitete për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen për zhvillimin vetjak, përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Për të zhvilluar këtë kompetencë, shkolla iu krijon nxënësve kushte që të kuptojnë tërësisht ndërvarësinë ndërmjet dukurive ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë vendore dhe globale. Ajo mundëson që nxënësit të orientohen drejt së ardhmes, të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat. Njëkohësisht, shkolla i ballafaqon nxënësit me problemet ekologjike, për t'i ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin, e shprehur nëpërmjet rezultateve të të nxënësve

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit:

- paraqesin veten me shkrim dhe me gojë, duke përpiluar CV (biografinë) në formatet e kërkuara;
- demonstrojnë kompetencat e nevojshme për situatat e ndryshme jetësore dhe drejtimit e ndryshme të karrierës;
- hulumtojnë dhe shfrytëzojnë mundësi për arsimim, për përgatitje profesionale si dhe për këshillim;
- demonstrojnë shkathtësi organizative, marrin nisma dhe punojnë në grup;
- planifikojnë dhe menaxhojnë projekte për të arritur objektiva të caktuara (udhëheqin,



delegojnë, analizojnë, komunikojnë, raportojnë, vlerësojnë, monitorojnë, mentorojnë);

- identifikojnë dhe vlerësojnë burimet e nevojshme (p.sh. kohën, mjetet financiare, burimet njerëzore);
- tregojnë fleksibilitet, shpirt krijues, përgjegjshmëri për t'iu përshtatur rrethanave të reja, gjatë realizimit të një detyre;
- ndërmarrin nisma;
- demonstrojnë solidaritet dhe konkurrojnë me ndershmëri, gjatë realizimit të detyrave të caktuara.

2.1.5 Kompetenca personale

Për të zhvilluar kompetencën personale, shkollat përgatisin nxënësit të përfshihen në mënyrë efektive në jetën familjare, shoqërore dhe në punë. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen të ndërjegjësohen për veten dhe të kenë vetëbesim, si dhe të jenë të hapur dhe të kenë besim tek të tjerët.

Kompetenca personale, e shprehur nëpërmjet rezultateve të nxënësit

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit :

- demonstrojnë vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale;
- njohin përparësitë dhe dobësitë e tyre;
- zhvillohen duke u mbështetur në përparësitë e tyre dhe punojnë për kapërcimin e dobësive;
- menaxhojnë emocionet e tyre;
- bashkëpunojnë dhe mirëkuptojnë të tjerët;
- njohin, respektojnë dhe çmojnë kulturën e tyre si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve;
- shmangin paragjykimet dhe bëjnë kompromise;
- menaxhojnë stresin, traumat dhe zgjidhin në mënyrë konstruktive konfliktet me të tjerët;
- kuptojnë dhe u përmbahen kodeve të sjelljes, në situata të ndryshme;
- jetojnë në mënyrë të shëndetshme;
- bëjnë zgjedhje dhe marrin vendime të informuara lidhur me shëndetin, dietat dhe



ushtrimet;

- ndjekin planet vetjake të jetesës dhe vlerësojnë shkallën e arritjes së qëllimeve të synuara;
- veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tyre.

2.1.6 Kompetenca qytetare

Të mësuarit për të jetuar së bashku trajtohet si sfida kryesore e botës së sotme dhe së nesërme. Qytetaria shtetërore sot plotësohet me aspektin shumë të rëndësishëm të “qytetarisë globale”. Kjo kompetencë siguron që nxënësit të jenë në gjendje të veprojnë si qytetarë të përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë.

Kompetenca qytetare, e shprehur nëpërmjet rezultateve të nxënimit

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit:

- kuptojnë ligjësitë e zhvillimit e mjedisit të tyre shoqëror dhe mënyrën e funksionimit të tij (p.sh. strukturën, kulturën, shprehitë, rregullat dhe pritshmëritë);
- mbështetin të drejtat e njeriut, si bazë e demokracisë;
- ushtrojnë të drejtat e tyre dhe respektojnë të drejtat e të tjerëve;
- vlerësojnë shumëllojshmërinë dhe demonstrojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
- menaxhojnë dhe zgjidhin konfliktet të në mënyrë konstruktive;
- marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes demokratike në të gjitha nivelet (p.sh., në familje, në shkollë, në komunitet, si dhe në proceset e politikave vendore dhe shtetërore);
- demonstrojnë vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme (p.sh. respekti i dinjitetit vetjak, shmangia e paragjyqimeve dhe diskriminimit të të gjitha llojeve, promovimi i barazisë gjinore);
- tregojnë interes për çështjet publike dhe kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve në nivel shkolle dhe komuniteti;
- mbrojnë mjedisin dhe kontribuojnë për zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

2.1.7 Kompetenca digjitale



Kompetenca digjitale nënkupton përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në punë, gjatë kohës së lirë dhe gjatë komunikimit. Ajo mbështetet në shkathtësitë themelore të përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet.

Kompetenca digjitale

Në fund të arsimit të mesëm të lartë, nxënësit:

- ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë me moshatarët, ekspertët apo të tjerët duke përdorur shumëllojshmërinë e medieve digjitale;
- përdorin media dhe formate të ndryshme për komunikimin e informacionit dhe ideve në mënyrë efektive për audiencë të shumta;
- zhvillojnë vetëdijen/ndërgjegjësimin mbi globalizimin dhe larminë kulturore duke u përfshirë në ndërveprim me nxënës nga kulturat e tjera;
- kontribuojnë në rritjen e rendimentit të punës në grupet e projekteve për të sjellë produkte origjinale apo për të zgjidhur problemet;
- ruajnë etikën e komunikimit personal dhe të grupit;
- gjejnë, organizojnë, analizojnë, vlerësojnë, përpunojnë dhe përdorin informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe medieve;
- përzgjedhin burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë e tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrash (apo problemeve të veçanta);
- ruajnë sigurinë e identitetit virtual dhe privatësinë personale;
- përzgjedhin dhe përdorin aplikacionet në mënyrë efektive dhe produktive;
- zgjidhin problemet e sistemeve dhe aplikacioneve;
- kuptojnë dhe përdorin saktë sistemet e teknologjisë.



3 Parimet e përgjithshme të zhvillimit të kurrikulës

Korniza Kurrikulare rregullon sistemin e arsimit parauniversitar. Funksionimi i mirë i këtij sistemi arrihet nëpërmjet respektimit të disa parimeve të përgjithshme. Parimet e mëposhtme janë referenca kryesore për hartimin e të gjitha dokumenteve kurrikulare:

Konceptim i gjerë dhe me bazë kompetencash i kurrikulës

Kurrikula, në kuptimin e gjerë, është harmonizim dinamik i kurrikulës së planifikuar që shtjellohet në dokumentet e shkruara zyrtare, kurrikulës së zbatuar (asaj që zhvillohet e zbatohet realisht në praktikën e shkollës) dhe kurrikulës së përvetësuar. Kurrikula e konceptuar në këtë mënyrë përfshin përmbajtjet mësimore, mjedisin e të nxënësve, metodat e mësimdhënies, burimet e të nxënësve, praktikatat e vlerësimit dhe mënyrat e shumta të bashkëveprimit ndërmjet nxënësve, mësuesve dhe komunitetit.

Kjo kurrikul siguron kushtet e nevojshme që nxënësit të ndërtojnë njohuri të reja dhe kompetenca, qëndrime dhe vlera, të zbatueshme në situata dhe kontekste të ndryshme, arsimore ose jetësore.

Përcaktimi i kompetencave kyçe, të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, që duhen të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit, si dhe përcaktimi i kriterëve për vlerësimin e arritjeve të rezultateve sigurojnë kushtet për mundësi të barabarta për arsimim për të gjithë nxënësit, për vlerësim të saktë të cilësisë së arsimit që ofrohet në nivel kombëtar apo vendor, për vlerësim të drejtë të nivelit të arritjeve të nxënësve etj.

Gjithëpërfshirja

Kurrikula duhet të njohë, të pranojë, të respektojë dhe t'u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve, pavarësisht nga prejardhja ose veçoritë e tyre. Ky parim synon të ndërtojë një kurrikul që krijon mundësi të barabarta për sukses të çdo nxënësi.

E udhëhequr nga ky parim, kurrikula duhet të ofrojë zgjidhje që mbajnë parasysh nevojat vetjake dhe stilet e të nxënësve, si dhe përvojat mësimore paraprake të nxënësve, si kusht për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre.

Baraspesha dhe integrimi



Kurrikula organizohet në fusha të nxëni që kanë në themel ndarjen dhe integrimin real të fushave të dijes. Si e tillë, kurrikula duhet të sigurojë njëherësh baraspeshën ndërmjet njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre.

Shkalla, thellësia dhe forma e integritit kushtëzohen nga veçoritë e fushave, lëndëve, temave etj., të nevojshme për t'u integruar. Kjo do të thotë që integrimi është proces dinamik që varet nga nevojat për ndryshim në përvetësimin e njohurive, shkathtësive etj., si dhe nga situatat e të nxënit.

Vijimësia

Nxënësit zhvillohen dhe nxënë me ritme dhe mënyra të ndryshme, duke i ndërtuar njohuritë e tyre mbi bazën e njohurive dhe të përvojës së tyre të mëparshme. Për këtë arsye, kurrikula hartohet dhe zbatohet në harmoni me veçoritë kryesore të grupmoshave dhe në varësi të mundësive dhe të gatishmërisë së fëmijëve për të nxënë. Në të njëjtën kohë, kurrikula i qartëson nxënësit dhe prindërit e tyre për drejtimin, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënit në shkallë dhe nivele të ndryshme arsimore, të cilat janë bazë për nivelet dhe shkallët pasardhëse.

Bashkëpunimi dhe partneriteti

Arsimi është përgjegjësi e përbashkët e nxënësve, mësuesve, prindërve, specialistëve të arsimit dhe gjithë shoqërisë. Për këtë arsye, planifikimi, hartimi, zbatimi i kurrikulës dhe, mbi të gjitha, arritja e rezultateve të të nxënit kërkojnë bashkëpunim të përgjegjshëm të të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara.

Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle, si dhe përgjegjshmëria

Autonomia dhe fleksibiliteti për zbatimin e kurrikulës në nivel shkolle kanë të bëjnë me mundësinë dhe përgjegjësinë e shkollës për:

- pasurimin e kurrikulës në përshtatje me natyrën dhe llojin e shkollave, duke mundësuar frytshmëri më të lartë të procesit të të nxënit në një kohë të dhënë;
- përshtatjen e kurrikulës me nevojat e larmishme të nxënësve, duke mundësuar edhe individualizimin e mësimdhënies;



- krijimin e mundësive për lëndë shtesë, të përshtatshme dhe të pëlqyeshme për grupe të caktuara nxënësish;
- krijimin e hapësirave që, krahas kurrikulës bërthamë, të përfshihen edhe programe ose module lëndore që lidhen me arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- përfshirjen aktive të shkollave në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të përvojave të mësimdhënies, duke rritur përgjegjësinë e tyre për rritjen e arritjeve të nxënësve;
- përfshirjen aktive të shkollave dhe njësive arsimore vendore në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt përmbushjes së kërkesave të kurrikulës zyrtare.



4 Nivelet e arsimit parauniversitar, shkallët e kurrikulës dhe roli i tyre në organizimin dhe vlerësimin e procesit mësimor-edukativ në shkollë

Sistemi arsimor parauniversitar mbështetet në traditën pozitive të arsimit, funksionon në zbatim dhe në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës në fuqi dhe zhvillohet në respekt të vlerave të përbashkëta të sistemeve arsimore bashkëkohore.

Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (KSNA)	Struktura e arsimit parauniversitar	Moshat
KSNA 4	Arsim pas të mesmes, jouniversitar	18 +
KSNA 3	Arsim i mesëm i lartë Klasat X – XII	15 – 17
KSNA 2	Arsim i mesëm i ulët Klasat VI – IX	11 – 14
KSNA 1	Arsim fillor Klasat I – V	6 – 10
KSNA 0	Klasa përgatitore	5 – 6
	Arsim parashkollor	3 – 6

Përgjatë niveleve të arsimit formal, nxënësit përgatiten për të nxënë gjatë gjithë jetës, për botën e punës në epokën e dijes së bazuar në digjitalizim.

Krahasuar me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, Korniza Kurrikulare u referohet vetëm 4 niveleve formale të arsimit dhe formimit. Me këtë, ofrohet një platformë e cila, njëherazi, është dritare e hapur për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe për arsimimin e të rriturve. Prandaj, në të gjitha shkallët e kurrikulës dhe në të gjitha fushat e të nxënit theksohen mundësitë që u ofrohen nxënësve për të arritur kualifikimet kombëtare të bazuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.



4.1 Struktura e arsimit parauniversitar. Veçoritë e niveleve arsimore dhe ndikimi i tyre në kurrikul

Arsimi parauniversitar integron:

1. arsimin parashkollor që u ofrohet fëmijëve të moshës 3-6 vjeç pranë institucioneve parashkollore dhe fëmijëve 5-6 vjeç, në klasat përgatitore, pranë shkollave fillore dhe 9-vjeçare;
2. arsimin fillor që ofrohet nga klasa e parë deri në klasën e pestë;
3. arsimin e mesëm të ulët që ofrohet nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë;
4. arsimin e mesëm të lartë që ofrohet në klasën e dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë. Në këtë nivel bëjnë pjesë gjimnazi, arsimi i mesëm profesional (i cili mundësohet deri në klasën e trembëdhjetë) dhe arsimi i mesëm i orientuar (i cili, në disa degë, shtrihet dhe në klasën e trembëdhjetë).

Në vijim janë paraqitur karakteristikat e niveleve arsimore, ndikimi i tyre në kurrikul dhe procesi i të nxënit që ato shpalosin.

4.1.1 Arsimi parashkollor

Edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë arsimor, gjatë të cilit fëmijët (mosha 3-6 vjeç) edukohen në institucione parashkollore. Edukimi parashkollor mbështetet në standardet e zhvillimit dhe të nxënit në fëmijërinë e hershme.

Mosha parashkollore paraqet një periudhë të zhvillimit të shpejtë fizik, njohës, emocional dhe social të fëmijëve. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj periudhe, ekspozimi i fëmijëve ndaj proceseve elementare të të nxënit përqendrohet në nxitjen e kërshërisë për veten, për shoqërinë, natyrën, kulturën dhe teknologjitë e reja. Synim i punës edukative gjatë kësaj periudhe është nxitja e krijimtarisë dhe e entuziazmit për përvojat e reja dhe situatat jetësore.

Gjatë këtij niveli të arsimit, fëmijët ndihmohen për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të komunikimit në gjuhën amtare, në situata të thjeshta të përditshme, për zhvillimin e aftësive të përqendrimit dhe për zhvillimin e aftësive shoqërore bazë.



Gjatë kësaj faze, u kushtohet vëmendje e veçantë zhvillimit fizik nëpërmjet veprimtarive fizike, përvojave që rrisin vetëdijen e fëmijëve për nevojën e mbrojtjes së tyre fizike, si dhe kujdesit për shëndetin.

4.1.2 Klasa përgatitore

Kjo klasë krijon kushtet që fëmijët të njohin elementet bazë të leximit, të shkrimit dhe të llogaritjes me numra. Fëmijët njohin elementet e shkronjave dhe strukturën e një teksti të thjeshtë, duke shfrytëzuar fotografi/vizatime dhe duke analizuar elementet e një piktore. Te kjo moshë, veprimtaritë e lidhura me artet duhet të jenë pjesë e rëndësishme e programit, që të zhvillojnë ndjeshmërinë dhe sferën emocionale të fëmijëve.

4.1.3 Arsimi fillor (Klasa I-V)

Në arsimin fillor, përvojat mësimore i shërbejnë përshtatjes së fëmijëve me një formë më të sistemuar të të nxënësve nëpërmjet lojës, punës, mësimi, si dhe aftësimit të tyre për të bërë dallimin mes lojës dhe detyrës. Realizimi i procesit mësimor bëhet në mënyrë të integruar, në mënyrë që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu të kuptohet në mënyrë sa më të plotë.

Gjatë arsimit fillor, procesi i të nxënësve përqendrohet në përvetësimin e bazave të leximit-shkrimit dhe në hedhjen e bazave të shëndosha për zhvillimin njohës, socio-emocional dhe motorik. Kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv ndaj të nxënësve, si bazë për zhvillimin e kompetencës kyçe “Të mësuarit për të nxënë”.

Procesi mësimor në arsimin fillor organizohet, ofrohet, lehtësohet dhe bashkërendohet nga mësuesi i klasës, i ndihmuar, sipas nevojës, nga asistenti dhe mësuesi i specializuar i lëndës.

4.1.4 Arsimi i mesëm i ulët

Arsimi i mesëm i ulët u ofron nxënësve sfida të reja për zhvillimin e tyre intelektual, shoqëror, etik, fizik, shpirtëror etj. Kërshëria e natyrshme e nxënësve nxitet më tej, për të siguruar njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera të qëndrueshme, si bazë për nivelet më të larta të arsimimit.

Në këtë nivel, bazuar në arritjet e të siguruar në nivelin paraprak arsimor, nxënësve ndihmohen të përforcojnë hap pas hapi arritjet e tyre për të lexuar dhe shkruar, duke bërë funksionale dhe të qëndrueshme aspekte të ndryshme të informacionit, kulturës, shkencës dhe



të teknologjisë. Kjo, në thelb, nënkupton të nxënit për t'iu qasur informacionit në mënyrë efikase dhe efektive, për ta vlerësuar atë në mënyrë kritike e me kompetencë dhe për ta shfrytëzuar në mënyrë të saktë dhe krijuese.

Në këtë nivel i kushtohet rëndësi aftësimit të nxënësve për të deshifruar, për të interpretuar dhe për të zbuluar llojet dhe modelet e dijes, si dhe për të shfrytëzuar imagjinatën pamore për komunikimin e ideve. Po kështu, nxënësi i këtij niveli aftësohet për të shfrytëzuar me efikasitet kohën dhe për të komunikuar idetë, për të gjetur dhe shfrytëzuar burimet e shumta të informacionit gjatë procesit mësimor (bibliotekat elektronike, mediat e besueshme, motorët e kërkimit etj.), për sistemimin dhe ruajtjen e materialeve dhe të detyrave mësimore në formën elektronike, për llogaritje të shpejta dhe të sakta etj.

Në këtë nivel, kurrikula pasurohet me përvoja të larmishme të nxënit (p.sh. kombinimi i qasjeve teorike me praktikën; të menduarit abstrakt dhe veprimet e kontekstualizuara, kontakti me realitetin konkret dhe virtual etj.), që ata të identifikojnë atë që u pëlqen dhe fushat e interesit.

4.1.5 Arsimi i mesëm i lartë

Arsimi i mesëm i lartë bazohet në një proces më të gjerë, më të thellë dhe më të specializuar të të nxënit, që merr parasysh aftësinë e nxënësve për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe orientimin e tyre të ardhshëm drejt studimeve e kualifikimeve të mëtejshme dhe tregut të punës.

Në këtë nivel, si në shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm (gjimnazet), ashtu edhe në shkollat profesionale, procesi i përvetësimit të dijeve dhe zhvillimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve e vlerave bazohet në nevojën e të rinjve për të marrë përgjegjësi për jetën e tyre, për të marrë pjesë si qytetarë aktivë dhe kompetentë në zhvillimet shoqërore dhe për t'u inkuadruar me sukses në tregun e punës.

Ky nivel arsimor ofron mundësi që nxënësit të kuptojnë, zhvillojnë dhe komunikojnë ide dhe informacione në gjuhën shqipe standarde; të lexojnë, shkruajnë, dëgjojnë e komunikojnë ide dhe informacione të paktën në një gjuhë të huaj; të analizojnë faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë, të shfaqin të kuptuarit e botës si një bashkësi sistemesh të ndërvarura; të marrin, të analizojnë, të vlerësojnë dhe të përdorin informacione nga burime të ndryshme.



Atyre do t'u mundësohet njohja më e thelluar e mjedisit shoqëror, natyror e kulturor në të cilin veprojnë dhe përdorimi i aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për të punuar e bashkëpunuar me të tjerët.

Arsimi i mesëm i lartë mundëson që nxënësit të thellohen në njohjen dhe kuptimin e ligjeve bazë të shkencave të natyrës dhe në kuptimin e vlerës praktike të njohurive të fituara.

Nxënësit e këtij niveli përfshihen në procese që synojnë kuptimin e sistemit të vlerave dhe krijimin e sistemit vetjak të vlerave duke u bazuar në të kuptuarit e çështjeve morale dhe shpirtërore.

4.2 Shkallët e kurrikulës dhe roli i tyre në organizimin dhe vlerësimin e procesit mësimor dhe edukativ në shkollë

Korniza Kurrikulare është e strukturuar në gjashtë shkallë, të cilat paraqesin periudha me karakteristika të përbashkëta, për sa i përket zhvillimit të fëmijëve dhe kërkesave të kurrikulës. Ato paraqesin pikën e referimit për caktimin e kompetencave kyç që duhen zotëruar, kërkesat e progresit të nxënies, organizimin e përvojave të nxënies, qasjen dhe kriteret e vlerësimit si dhe institucionin përgjegjës për arritjen e tyre.

Strukturimi dhe organizimi i kurrikulës sipas shkallëve të kurrikulës mundëson:

- respektimin e karakteristikave të periudhave të ndryshme të zhvillimit të fëmijëve për caktimin e qëllimeve specifike dhe të kompetencave që duhen zotëruar nga fëmijët;
- respektimin e ritmeve individuale të nxënësve, drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës;
- lidhjen e qartë të rezultateve të të nxënësve gjatë shkallëve të kurrikulës, si pikë referimi për planifikimin dhe organizimin e punës mësimore-edukative në nivel shkolle;
- fleksibilitet më të madh në planifikimin dhe organizimin e punës mësimore-edukative, nëpërmjet zgjerimit të ciklit të planifikimit të nxënies nga një vit shkollor në dy/tri vite shkollore (në varësi nga shkalla konkrete e kurrikulës);
- përgatitjen e udhëzimeve të qarta për organizimin e punës mësimore-edukative gjatë shkallëve të kurrikulës, në mënyrë të veçantë për metodat e punës dhe format e vlerësimit;



- forcimin e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies së shkollës dhe të njësive arsimore vendore për cilësinë e arsimit që ofrohet nga shkolla.

Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (KSNA)	Nivelet e sistemit të arsimit formal	Shkallët e kurrikulës
KSNA 3	Arsim i mesëm i lartë Klasat XII	<i>Shkalla 6 e kurrikulës</i> Konsolidim i arritjeve dhe specializim
	Arsim i mesëm i lartë Klasat X – XI	<i>Shkalla 5 e kurrikulës</i> Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional
KSNA 2	Arsim i mesëm i ulët Klasat VII – IX	<i>Shkalla 4 e kurrikulës</i> Përforcim i arritjeve dhe orientim në karrierë
	Arsim i mesëm i ulët Klasat VI – VII	<i>Shkalla 3 e kurrikulës</i> Zhvillim i mëtejshëm i bazave dhe orientim
KSNA 1	Arsim fillor III – V	<i>Shkalla 2 e kurrikulës</i> Përforcim i bazave dhe zhvillim
	Arsim fillor I – II	<i>Shkalla 1 e kurrikulës</i>
KSNA 0	Klasa përgatitore	Përvetësim i bazave për njohje
	Mosha 3 – 6 vjeç	<i>Shkalla përgatitore e kurrikulës</i> Edukimi në fëmijërinë e hershme

4.2.1 Shkalla përgatitore: Edukimi në fëmijërinë e hershme

Kjo shkallë përfshin edukimin e fëmijëve 3 – 6 vjeçar në institucionet parashkollore dhe në klasat përgatitore, të hapura pranë shkollave fillore ose 9-vjeçare. Kjo periudhë përcaktohet si faza fillestare përgatitore e nxënies së organizuar të fëmijëve parashkollorë.

Edukimi parashkollor mbështetet në karakteristikat e zhvillimit moshor dhe të të nxënit të fëmijëve 3 – 6 vjeç. Kjo moshë paraqet një periudhë të rëndësishme të zhvillimit të shpejtë fizik, njohës, gjuhësor, emocional dhe social të fëmijëve. Procesi i nxënies do të fokusohet në nxitjen e kërshërisë së fëmijëve për veten, për shoqërinë, për natyrën, për dijen njerëzore, për kulturën dhe për teknologjitë e reja, për nxitjen e krijimtarisë dhe të dëshirës për të përjetuar përvoja të reja, si dhe për të përballur situata të përditshme jetësore.



Mbi bazën e të nxënit nëpërmjet lojës, fëmijët ndihmohen për zhvillimin e shkathtësive të komunikimit në gjuhën amtare në situata të përditshme, për zhvillimin e vëmendjes dhe të aftësive të përqendrimit, si dhe për zhvillimin e aftësive themelore sociale.

Shumica e fëmijëve vijnë në kopsht me një vëllim të konsiderueshëm të njohurive intuitive matematike, të cilat i kanë përftuar nëpërmjet eksplorimeve të mjedisit rrethues, të përdorimit të lojërave formuese, të ndërtimeve me kuba etj. Nxënia e matematikës në arsimin parashkollor ndërtohet mbi këtë bazë dhe i zhvillon më tej konceptet dhe shprehitë matematikore.

Kureshtja dhe dëshira e fëmijëve parashkollorë për të eksploruar mjedisin rrethues zhvillojnë aftësitë e tyre për të bërë pyetje të thjeshta, matje, ndarje, klasifikime dhe për të shkëmbyer informacion rreth botës që i rrethon. Dijet shkencore kanë një rëndësi të veçantë për t'u përvetësuar nga fëmijët e kësaj moshe, me qëllim njohjen dhe kuptimin e proceseve jetësore dhe të vetive të materialeve me të cilat fëmijët janë në kontakt të përditshëm.

Nëpërmjet edukimit artistik fëmijët parashkollorë mësojnë të njohin e të kuptojnë vlerat që përcjell arti. Ata e shfaqin veten nëpërmjet formave dhe mënyrave të ndryshme që u mundëson muzika, arti pamor, drama dhe kërcimi.

Vëmendje të veçantë në vitet e edukimit parashkollor i kushtohet zhvillimit fizik të fëmijëve nëpërmjet organizimit të Veprimtarive fizike dhe veprimtarive sportive, kujdesit për veten, për higjienën vetjake, për mirëqenien fizike, shëndetësore dhe sigurinë e jetës.

4.2.2 Shkalla e parë: Përvetësim i bazave për njohje

Kjo shkallë përfshin klasën përgatitore, klasën I dhe klasën II. Në këtë shkallë, vendoset baza për të nxënit sistematik. Procesi i të nxënit përqendrohet në:

- njohjen dhe të kuptuarit nga nxënësit të të drejtave, detyrave dhe përgjegjësive në klasë, në shkollë dhe në familje;
- përvetësimin e elementeve themelore të leximit dhe të shkrimit në gjuhën amtare dhe të llogaritjeve numerike;
- hulumtimin e mjedisit në mënyrë sistematike;
- përmbushjen e detyrave të caktuara, duke respektuar afatet e caktuara kohore;
- përballjen vetjake dhe në grup me përvojat e ndryshme të të nxënit.



4.2.3 Shkalla e dytë: Përforcim i bazave dhe zhvillim

Kjo shkallë përfshin klasat III, IV dhe V. Në këtë shkallë, nxënësit ndihmohen për të konsoliduar përvetësimin e bazave në lexim, shkrim, komunikim dhe teknika të të nxënit, si bazë për zhvillim të mëtejshëm.

Në këtë shkallë, fëmijët përballen me sfida si:

- përdorimi i drejtë i elementeve themelore të gjuhës amtare dhe i gjuhës angleze në komunikimin verbal dhe me shkrim;
- përdorimi i drejtë i simboleve dhe i operacioneve;
- shpalosja e fushave të reja të nxënies dhe thellimi i informacioneve;
- zhvillimi i aftësive për të menduar, për të strukturuar dhe për të orientuar zgjidhjen e problemeve;
- kuptimi i përgjegjësisë për vetveten, për të tjerët dhe për mjedisin;
- zgjerimi i burimeve të dijes;
- kultivimi i pavarësisë në planifikimin dhe realizimin e detyrave;
- lidhja e teorisë me problemet praktike;
- zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve;
- qëndrimi kritik ndaj zgjidhjes së problemeve.

4.2.4 Shkalla e tretë: Zhvillim i mëtejshëm i bazave dhe orientim

Kjo shkallë përfshin klasën VI dhe VII. Ajo synon thellimin e njohurive, në fushat e ndryshme të të nxënit, duke siguruar bazën fillestare për orientim akademik dhe për karrierë. Nxënësit u nënshtrohen sfidave për:

- zhvillimin e mendimit abstrakt dhe kompleks (p.sh. aftësitë e larta intelektuale) që është i nevojshëm për të njohur botën dhe veten, si dhe për zgjidhjen e problemeve;
- njohjen më të thellë të vetes, të të tjerëve dhe të mjedisit natyror e shoqëror;
- zhvillimin e aftësive për vetëvlerësim;
- zhvillimin e aftësive për komunikim efektiv, duke përfshirë dhe konceptet ose kategoritë matematikore dhe shkencore;
- zgjerimin e mundësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në gjuhën amtare, në gjuhën angleze dhe në gjuhën e huaj të dytë;



- zhvillimin e përgjegjshmërisë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe për mbrojtjen të mjedisit.

4.2.5 Shkalla e katërt: Përforcim i arritjeve dhe orientim në karrierë

Kjo shkallë përfshin klasat VIII dhe IX. Ajo synon t'i orientojë nxënësit që të marrin parasysh mundësitë e ndryshme të karrierës. Ata ballafaqohen me sfida që kanë të bëjnë me:

- përdorimin e burimeve të informacionit dhe qëndrimin kritik ndaj tij;
- zhvillimin e interesit për jetën publike nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë në veprimtari të ndryshme jashtëshkollore;
- përballjen me çështje të ndryshme nga jeta reale nëpërmjet projekteve që do të mundësojnë konsolidimin e njohurive të tyre dhe zhvillimin e mëtejshëm të aftësive, vlerave dhe qëndrimeve;
- familjarizimin me mundësitë e ndryshme të studimit dhe orientimit në karrierë;
- përgatitjen praktike dhe veprimtaritë orientuese që u mundësojnë qartësimin e aspiratave të tyre;
- përforcimin e aftësive të vetëvlerësimit;
- përforcimin e kompetencave për punë të pavarur, individuale dhe në grup.

4.2.6 Shkalla e pestë: Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional

Kjo shkallë përfshin klasat X dhe XI. Ajo i ballafaqon nxënësit me studime më të thella dhe më të specializuara, për të qenë të gatshëm të vazhdojnë arsimin e lartë dhe/ose për të hyrë në tregun e punës. Nxënësit përballen me sfida që mundësojnë:

- zhvillimin e vetëbesimit;
- studimin e thellë dhe të specializuar, duke angazhuar aftësitë për shfrytëzim të burimeve të ndryshme, me një qasje kritike ndaj të dhënave të ndryshme që përdorin;
- përkushtim dhe qëndrueshmëri për arritje më të larta, në mësim dhe përgatitje për karrierë si dhe për jetë personale, profesionale dhe publike;
- përgatitje për të marrë përgjegjësi për jetën e tyre, për të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore si qytetarë të përgjegjshëm dhe kompetentë si dhe për të konkurruar me sukses në tregun e punës;
- zhvillim si individë dhe si anëtarë të shoqërisë, të aftë dhe me kapacitete të nevojshme për jetë dhe punë që të përballin ndryshimet e ekonomisë vendore dhe globale dhe të mësojnë



si të bëjnë zgjidhjen e problemeve në situata të ndryshme në jetën personale dhe profesionale;

- përgatitjen për jetë, që të jetojnë të pavarur dhe të përballojnë sfidat dhe të shfrytëzojnë mundësitë që ofron shoqëria bashkëkohore.

4.2.7 Shkalla gjashtë: Konsolidim i arritjeve dhe specializim

Kjo shkallë përfshin klasën XII. Ajo shënon kalimin nga adoleshenca në fazën e pjekurisë. Programet e shkollave të mesme përgatitin nxënësit për t'u përfshirë në tregun e punës. Nxënësit u ekspozohen sfidave si:

- demonstrimi i aftësive për identifikim të burimeve të domosdoshme dhe për qasjen kritike ndaj të dhënave të ndryshme;
- demonstrimi i aftësisë për vendimmarrje të pavarur dhe për marrjen e përgjegjësive për zgjedhjet dhe veprimet vetjake;
- demonstrimi i përkushtimit të tyre për angazhim të vazhdueshëm për të nxënë, për studim të mëtejshëm dhe/apo për zhvillim profesional;
- demonstrimi i shkathtësive për të zhvilluar dhe për të promovuar strategji për planifikimin e karrierës nëpërmjet kërkimit të shembujve dhe inovacioneve, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e idesë së sipërmarrjes;
- demonstrimi i shkathtësive për ndryshimin e konceptit të karrierës, nëpërmjet kërkimit në një spektër më të gjerë të punëve, duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive të transferueshme për mundësitë e karrierës në të ardhmen;
- përfshirje në procesin e planifikimit të karrierës vetjake.



5 Fushat e të nxënit dhe lëndët mësimore

Fushat e të nxënit

Fushat e të nxënit përbëjnë bazën e organizimit të procesit mësimor-edukativ në shkollë, për çdo nivel arsimor dhe shkallët përkatëse të kurrikulës.

Fushat e të nxënit:

1. Gjuhët dhe komunikimi
2. Matematikë
3. Shkencat e natyrës
4. Shoqëria dhe mjedisi
5. Arte
6. Edukim fizik, sporte dhe shëndet
7. Teknologji dhe TIK

Çdo fushë ka rezultatet e saj të të nxënit që u përkasin zhvillimit të kompetencave kyçe. Fushat e të nxënit përfshijnë një ose më shumë lëndë apo module. Lëndët dhe modulet bazohen në rezultatet e të nxënit të përcaktuara për çdo fushë. Disa lëndë të fushës mund të jenë pjesë e disa shkallëve kurrikulare.

Në fushat e të nxënit, të renditura më poshtë, përcaktohen synimet e të nxënit të cilat mundësojnë arritjen e kompetencave kyçe.

5.1 Gjuhët dhe komunikimi

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” u mundëson nxënësve të zhvillojnë dhe të përdorin gjuhët si mjete komunikimi në jetën e përditshme, si dhe në veprimtaritë e tyre profesionale e shoqërore.

Nëpërmjet kësaj fushe nxënësit shprehin dhe interpretojnë koncepte, ide, ndjenja, fakte e opinione me gojë e me shkrim; zhvillojnë aftësitë për të lexuar, shkruar, folur dhe dëgjuar në mënyrë aktive dhe të qëllimshme; dallojnë dhe përdorin tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare, tekste të shtypura dhe elektronike; gjejnë, krahasojnë, analizojnë e vlerësojnë informacione të ndryshme; zotërojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e duhura rreth



sistemit gjuhësor; e përdorin gjuhën në mënyrë pozitive dhe të përgjegjshme në marrëdhëniet shoqërore; kuptojnë, analizojnë dhe vlerësojnë tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare, nga krijimtaria e autorëve që janë përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe dhe ajo botërore.

Kjo fushë përfshin lëndët: Gjuhë shqipe, Gjuhë amtare (për pakicat kombëtare), Gjuhë angleze, si dhe gjuhët e tjera.

Gjuha shqipe mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, nga klasa përgatitore deri në klasën XII.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e dytë dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë.

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa e gjashtë). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane etj.

5.2 Matematikë

Matematika përfaqësohet si fushë të nxëni dhe lëndë mësimore. Formimi matematik i nxënësve duhet t'i përgjigjet kërkesave të shoqërisë së sotme, e cila ka nevojë për individë të aftë në përdorimin dhe interpretimin e matematikës në një shumëllojshmëri kontekstesh. Matematika mundëson zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të menduar në mënyrë kritike dhe për të punuar në mënyrë të pavarur e sistematike. Ajo nxit kërkuesin dhe inkurajimin për zbulime, për marrjen e njohurive të reja me qëllim zbatimin e tyre dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Një nga aspektet më të rëndësishme është integrimi i matematikës me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare me qëllim që të zotërohen kompetencat kyçe.

Matematika mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës. Në shkallën e parë dhe të dytë trajtohet lidhja konceptuale për numrat, figurat gjeometrike, pozitën në hapësirë, matjet dhe shkathtësitë për llogaritje dhe zgjidhje të problemeve. Në shkallën e tretë dhe të katërt kjo lidhje integrohet me njohuritë nga algjebra, gjeometria dhe statistika, kurse në shkallën e pestë dhe të gjashtë sigurohet një zgjerim dhe thellim i njohurive edhe nga trigonometria, analiza matematike dhe probabiliteti. Në këto shkallë matematika është në funksion të përgatitjes së nxënësve për studime të mëtejshme.



Nëpërmjet mësimin të matematikës, nxënësit do të marrin njohuri mbi numrat, hapësirën, masat dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave (statistikës). Ata do të jenë në gjendje të kuptojnë rolin e të menduarit matematik për zhvillimin e shkencës e të teknologjisë moderne, si dhe rëndësinë e zbatimit të matematikës në situatat e zgjidhjes së problemeve nga jeta reale. Në këtë fushë, nxënësit vlerësojnë matematikën në tërësi si formë e përshkrimit, si metodë e njohjes së realitetit dhe si pjesë e kulturës njerëzore e progresit shoqëror.

5.3 Shkencat e natyrës

Shkenca është veprimtari intelektuale dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Kompetencat që kjo fushë zhvillon u shërbejnë individëve në aspektin personal, social dhe ekonomik.

Fusha e shkencës në arsimin parauniversitar ndihmon në formimin shkencor të gjithë nxënësve pa dallim nëpërmjet zhvillimit të qëndrimeve, aftësive dhe njohurive shkencore të nevojshme për të hetuar, për të zgjidhur problemet, për të marrë vendimet, për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për të bërë pyetje e kënaqur kureshtjen e tyre.

Përvojat e të nxënit nëpërmjet situatave të ndryshme në shkencë, u krijojnë nxënësve mundësi të shumta për të eksploruar, analizuar, vlerësuar, sintetizuar, çmuar dhe kuptuar marrëdhëniet ndërmjet shkencës, teknologjisë, shoqërisë dhe mjedisit, të cilët ushtrojnë ndikime në jetën, karrierën dhe të ardhmen e tyre.

Nëpërmjet të nxënit të shkencës ata vlerësojnë rolin e shkencës në çështjet vendore, kombëtare dhe globale që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm, si ato që lidhen me shëndetin, burimet natyrore, mjedisin dhe ndikimin e veprimtarisë njerëzore dhe dukurive natyrore mbi të.

Të nxënit në shkencë bazohet në metodën empirike, vëzhgime dhe matje, si dhe në metodën racionale, në mendimin logjik matematikor. Duke u krijuar mundësitë e kryerjes së veprimtarive praktike në mënyrë të pavarur, nxënësit provojnë kënaqësinë e zbulimit shkencor dhe plotësojnë kuriozitetin mbi botën që i rrethon. Në këtë mënyrë, ata zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues dhe sfidojnë vetveten për të bërë pyetje dhe për të arritur në përfundime të bazuara në të dhëna dhe fakte duke përdorur metoda shkencore.



Të nxënit në fushën e shkencave të natyrës në shkallën 1 dhe shkallën 2 zhvillohet sipas qasjes së integruar të lëndëve: Biologji, Fizikë, Kimi, Gjeografi. Gjatë këtyre shkallëve nxënësit nxënë për mjedisin natyror dhe atë të krijuar nga njeriu, për marrëdhëniet mes mjedisit dhe njeriut, për metodat e kërkimit shkencor që i aftësojnë ata për studimin e dukurive natyrore.

Në shkallën 3 dhe në shkallën 4, fusha e shkencave natyrore integron njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: Biologji, Fizikë, Kimi. Në këto shkallë nxënësit zgjerojnë fushës e njohjes për dukuritë më të zakonshme në jetën dhe veprimtaritë e përditshme, zhvillojnë aftësitë, strategjitë dhe shprehjet e të menduarit të nevojshme për hetimin shkencor dhe skicimin teknologjik, lidhin njohuritë shkencore dhe teknologjike me njëra-tjetrën dhe me jetën, përdorin gjuhën dhe terminologjinë shkencore, si dhe krijojnë bazat konceptuale për të nxënit e mëtejshëm të shkencës.

Në shkallën 5 dhe shkallën 6, shkencat natyrore zhvillohen në lëndë të veçanta (Fizikë, Kimi, Biologji dhe Shkenca e Tokës). Fusha e shkencës në këto shkallë u krijon mundësi nxënësve që të zhvillojnë një bazë solide të njohurive shkencore biologjike, kimike, fizike, të shkencës së Tokës, si dhe kompetencat për të përzgjedhur dhe integruar njohuritë shkencore dhe metodat e nevojshme në shpjegimin dhe parashikimin e dukurive, për t'i zbatuar në mënyrë krijuese ato në situata dhe rrethana të reja, si dhe për të vlerësuar natyrën dinamike të njohurive shkencore. Nga ana tjetër, ajo u krijon mundësi atyre të vazhdojnë studimet e mëtejshme dhe të përballen me kërkesat e tregut të punës.

5.4 Shoqëria dhe mjedisi

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i aftëson nxënësit për të qenë qytetarë aktivë, të informuar dhe të përgjegjshëm për veten dhe shoqërinë. Përmes kësaj fushe nxënësit zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të luajtur rolin e tyre si anëtarë të një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Nxënësit aftësohen të vlerësojnë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm. Përmes kësaj fushe krijohen premisa për të nxitur iniciativën dhe sipërmarrjen.

Përmes fushës “Shoqëria dhe mjedisi” nxënësit zhvillojnë bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, e proceseve politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillojnë konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbatojnë këtë kuptim në analizën e pasojave të



veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri në të kaluarën dhe sot; zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë.

Në shkallën 1 dhe shkallën 2 nxënësit nxënë rreth marrjes së vendimeve, njohin dhe kuptojnë veten e tyre, shoqërinë dhe botën. Në shkallën 3 dhe shkallën 4, fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve të tilla, si: Histori, Gjeografi, Edukim qytetar. Shkalla dhe format e integritit ndryshojnë në varësi të niveleve moshore, tematikave dhe çështjeve të ndryshme. Në shkallën 5 dhe shkallën 6, Shoqëria dhe mjedisi realizohet nëpërmjet lëndëve: Histori, Gjeografi, Qytetari, Filozofi, Sociologji, Psikologji, Ekonomi, duke vënë theksin në zhvillimin e kompetencave përkatëse kyçe në mënyrë të baraspeshuar.

Përvojat mësimore të kësaj fushe të të nxënësve i shërbejnë përmbushjes së qëllimeve arsimore, si kultivimi i identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

5.5 Arte

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës, sepse studimi i tyre lidhet ngushtë me zhvillimin intelektual, emocional dhe social, kulturor të nxënësve. Ato janë pjesë integrale e jetës sonë të përditshme, ku gjejmë të mishëruara aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, në të cilën ndërveprojnë kultura dhe shoqëria.

Në shkallën 1,2 dhe në shkallën 3 aspektet e të nxënësve në fushën e arteve përfshijnë mundësitë për të njohur, për të realizuar dhe për të prezantuar punë të ndryshme artistike nëpërmjet muzikës, artit figurativ, kërcimit dhe dramës. Në shkallën 3 dhe shkallën 4 zhvillohen vetëm muzika dhe arti pamor. Në shkallën 5 dhe shkallën 6, në shkollat e mesme të përgjithshme (në gjimnaze), artet zhvillohen në lëndë të veçanta ose si një lëndë e vetme (Histori e arteve).

Pra, artet luajnë rol të rëndësishëm në formimin dhe zhvillimin e plotë të nxënësve, duke i ndihmuar të kuptojnë, të shprehin përvojat e tyre vetjake, të kultivojnë talentin e tyre, të përvetësojnë konceptet themelore për përdorimin e teknikave apo burimeve të ndryshme artistike; të mësojnë, të komunikojnë, të interpretojnë dhe të zhvillojnë shkathtësitë e tyre artistike për t’u shprehur, si dhe të ndihmojnë në ndryshimin artistik e kulturor të vetes dhe të të tjerëve.



5.6 Edukim fizik, sporte dhe shëndet

Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit në arsimin parauniversitar synon që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme, të cilat sigurojnë mirëqenien e shëndetit të tyre mendor, emocional, fizik dhe social, si dhe ndihmojnë në përballjen me sukses të sfidave të jetës.

Kjo fushë fillon të zbatohet në shkallën 1 të kurrikulës dhe është e pranishme deri në shkallën 6. Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit do të ofrojë një qasje e integruar të edukimit fizik dhe sporteve, me edukatën shëndetësore, që në shkallën 1 e deri në shkallën 6, duke përfshirë njohjen e mënyrave të jetës së shëndetshme apo mbrojtjen prej sëmundjeve dhe rreziqeve prej tyre.

Edukimi fizik dhe sportiv shihet si një mjet ideal për promovimin e aktivitetit të rregullt fizik, edukimin e një stili jetese të shëndetshme e aktive dhe fitimin e kompetencave të rëndësishme e të vlefshme përgjatë gjithë jetës.

Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit iu mundëson nxënësve, zbatimin në praktikë të njohurive teknike e taktike të fituara në disiplinat sportive; zbatimin e rregulloreve teknike të disiplinave sportive; kryerjen e kombinacioneve lëvizore me përmbajtje të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit lëvizor me dhe pa mjete, kryerjen e elementeve të thjeshta akrobatike; zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë të ushtruarit me aktivitet fizik e sportiv; njohjen dhe respektimin e dhënies së ndihmës së parë në raste të traumave që ndodhin gjatë aktivitetit fizik; zbatimin në jetën e përditshme të parimeve të Olimpizmit, Filozofisë Olimpike dhe Fair-Play-t.

Nëpërmjet aktivitetit fizik e sportiv, nxënësve u krijohet mundësia të marrin pjesë në një shumëllojshmëri veprimtarish fizike e sportive, individualisht dhe në grup, të kuptojnë rëndësinë e të ushtruarit sistematik, edukojnë disiplinën, vullnetin, vetëvlerësimin, konkurrencën. Gjithashtu, kjo fushë i ndihmon nxënësit të vlerësojnë sportin si alternativë karriere në të ardhmen.



5.7 Teknologji dhe TIK

Teknologjia dhe TIK-u, gjithnjë e më shumë, janë duke u përdorur në shoqëri dhe ekonomi. Ato janë rruga e transformimit të mënyrës së punës, studimit, komunikimit, marrjes së informacionit dhe ndër të tjera është mundësi për të kaluar në mënyrë produktive kohën e lirë.

Interneti dhe veçanërisht teknologjitë përdoren për shumë qëllime nga grupe të ndryshme nxënësish dhe ato janë gjithashtu duke përvetësuar aktivitete të reja shoqërore. Përmes hapësirave online nxënësit mund të kenë akses në burime, mund të ndjekin, ndërveprojnë, krijojnë dhe ndajnë me të tjerët në nivel global.

Shumëllojshmëria dhe shkalla e përdorimit ka ndryshuar nevojën për kompetencën lidhur me medien dhe teknologjinë. Rritja e përdoruesve të internetit forcon rëndësinë e tij si një multimedia. Një shoqëri globale e në ndryshim të shpejtë kërkon që, nxënësit të vlerësojnë nevojën dhe domosdoshmërinë e kapacitetit teknologjik, për të gjitha aspektet e jetës dhe punës. Lëndët që përmban fusha e teknologjisë dhe TIK-ut janë: Teknologji dhe TIK.

Zhvillimi i kapacitetit teknologjik, një qëllim kryesor për edukimin teknologjik, iu mundëson nxënësve të njohin mundësitë profesionale më të kërkuara dhe të shndërrohen në qytetarë të informuar, në një botë që ndryshon shpejt. Të gjithë nxënësit duhet të bëhen pjesëmarrës aktivë në të nxënit e tyre individual. Ata duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve, si dhe ndjenjën e përgjegjësisë për të nxënit vetjak, që të jenë krijues dhe nxënës autonomë, duke krijuar kështu bazat për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Nëse në fillim teknologjia dhe interneti shiheshin si një burim shqetësues apo vështirësie për nxënësit, sot theksi vihet në përdorimin produktiv dhe kritik në mjediset shoqërore dhe globale të internetit.

Nxënësit zbatojnë dhe i bëjnë të dukshme këto njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet përdorimit të TIK -ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burime on-line; për të menaxhuar projekte në grupe pune; për të diskutuar dhe shkëmbyer gjetjet e tyre gjatë kërkimeve.

Ata arrijnë të analizojnë probleme; të arsyetojnë dhe analizojnë konceptet, lidhjet informatike dhe proceset informatike; të formulojnë dhe organizojnë ide në të gjitha fushat e të nxënit.



Kompetenca digjitale si aftësi funksionale e lexim – shkrimit digjital nxit dhe zhvillon tek nxënësit dhe shprehi e aftësi të tjera funksionale si: shprehi matematikore, shprehi komunikuese, shprehinë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve, shprehi personale, shprehi për të punuar në grup, shprehi për të mësuar si të nxësh, shprehi për të përdorur një shumëllojshmëri burimesh e instrumentesh etj.

Bazuar në këto njohuri, qëndrime dhe shkathtësi që zhvillon Teknologjia dhe TIK-u tek nxënësit, duhet të theksojmë që për avancimin më të shpejtë të nxënësve në këtë fushë, ne duhet ta gjejmë të shtrirë në të gjitha fushat e të nxënit.

Në shkallën 1 kjo fushë realizohet e integruar tek fushat e tjera të të nxënit. Në shkallën 2 kjo fushë përfshin TIK-un dhe Teknologjinë, ndërsa në shkallën 3 dhe në shkallën 4 kjo fushë përqendrohet në zhvillimin e avancuar të shkathtësive të TIK-ut tek nxënësit.

5.8 Shpërndarja e kohës mësimore për fushat e të nxënit

Organizimi i kurrikulës në fusha të nxëni ka në themel ndarjen dhe integrimin real të këtyre fushave. Si i tillë, ky organizim mban parasysh baraspeshën ndërmjet njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre.

Fushat e të nxënit	KNSA 0		KNSA 1		KNSA 2		KNSA 3
	Shkalla 1		Shkalla 2	Shkalla 3	Shkalla 4	Shkalla 5	
	Klasa përgatitore	Klasa I – II	Klasa III – V	Klasa VI – VII	Klasa VIII – IX	Klasa X – XII	
1. Gjuhët dhe komunikimi	33%	41.6%	35.5%	28.6%	25%	21.5 %	
2. Matematikë	22%	20.8%	17%	14.3%	13.3%	10.9%	
3. Shkencat e natyrës	7%	5.2%	7.1%	12.5%	20%	17.4%	
4. Shoqëria dhe mjedisi	7%	5.2%	7.1%	14.3%	16.6%	17.4%	
5. Edukim fizik, sporte dhe shëndet	11%	10.3%	8.5%	7.1%	6.7%	3.3%	
6. Arte	17%	11.7%	10.6%	9%	6.7%	3.3%	
7. Teknologji dhe TIK ¹	3%	0%	5.7%	7.1%	5%	5.5%	

¹ Koha mësimore në këtë fushë, në klasën përgatitore, është vetëm për Teknologjinë.



Kurrikul me zgjedhje

5.2%

8.5%

7.1%

6.7%

20.7 %



6 Mësimdhënia dhe të nxënit efektiv

Metodologjitë mësimore në arsimin parauniversitar sigurojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në ndërtimin e njohurive, të shkathtësive, të qëndrimeve, të vlerave dhe të qëndrimeve. Metodatat e mësimdhënies marrin parasysh dhe plotësojnë nevojat e të nxëni efektiv.

Mësimdhënia dhe nxënia efektive:

- *siguron kompetencat për të nxënit gjatë gjithë jetës.* Aftësia për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese, aftësia për të përballuar situata problemore, për të menaxhuar informacionin, shprehitë e punës së pavarur individuale ose në grup, vetëvlerësimi etj., janë thelbësore për të siguruar këtë lloj të nxëni.
- *bazohet në bindjen se çdo nxënës mund të jetë i suksesshëm.* Mësimdhënia që nxit zhvillimin e kompetencave siguron kushtet dhe situatat e të nxënit për të gjithë nxënësit.
- *bazohet në njohuritë paraprake të nxënësve dhe e planifikon të nxënit mbi bazën e tyre.* Njohuritë paraprake të nxënësve janë kusht jo vetëm për përvetësimin e njohurive të reja, por edhe për realizimin e një mësimdhënieje ndërvepruese.
- *planifikohet për rezultate të nxëni që synojnë kompetencat.* Mësuesi saktëson rezultatet e pritshme të nxënësve të tij mbi bazën e kërkesave të gjithanshme të kurrikulës.
- *aftëson nxënësit të përdorin njohuritë.* Aftësimi i nxënësve për të përdorur njohuritë dhe shkathtësitë e fituara duhet të jetë synimi kryesor i procesit të mësimdhënies dhe të nxënit në shkollë.
- *siguron partneritetin mësues-nxënës në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit.* Ky partneritet rrit motivimin e nxënësve dhe krijon klimën dhe kushtet e domosdoshme për shfrytëzimin e njohurive dhe përvojave të nxënësve dhe mësuesve.
- *mbështetet në situata të nxëni reale ose të ngjashme me realitetin.* Ajo mundëson përzgjedhjen dhe përdorimin e situatave që hasen në jetën e përditshme, që nga jeta vetjake, familjare, shoqërore e deri tek e vendit, rajonit e më gjerë.



- *bazohet në parimin e integritit lëndor*, i cili pasqyron integrimin e dijeve njerëzore, të cilat kurrikula e zbatuar merr përsipër t'i zhvillojë. Në këtë mënyrë, mësimdhënia efektive kultivon të menduarit ndërlëndor.
- *përshkohet nga parimi i përzgjedhjes*. Ajo vë në përdorim forma të larmishme të veprimtarive mësimore, si: përmbajtje të veçanta kurrikulare, detyra të diferencuara, projekte, burime informacioni etj., që sigurojnë realizimin e këtij parimi.
- *zhvillohet mbi bazën e burimeve të shumëllojshme të informacionit*. Qëmtimi në burime alternative informacioni, përveç tekstit shkollor, është kusht i rëndësishëm për përvetësimin më të mirë të koncepteve dhe metodave dhe aftëson nxënësit për të nxënë gjatë gjithë jetës, për të përzgjedhur informacionet në mënyrë kritike.
- *mbështetet në TIK*. Të nxënit nëpërmjet TIK-ut luan rol të rëndësishëm në metodat e mësimdhënies. Shkollat duhet të eksplorojnë jo vetëm mundësitë e përdorimit të TIK-ut për të mbështetur mënyrat e mësimdhënies, por edhe hapësirat e tij, për të krijuar mënyra të reja e të ndryshme të nxëni.
- *përfshin sistematikisht nxënësit në eksperimente e vëzhgime*, për njohjen jo vetëm të natyrës, por edhe të shoqërisë.

Mësuesi është aktori kryesor i suksesit të mësimdhënies. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i tij mbetet kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve të synuara. Për këtë arsye, kurrikula, veçanërisht, ajo e arsimit bazë, kërkon ndryshimin e formimit fillestar të mësuesve, nëpërmjet rinovimit të kurrikulës së shkollave të larta e universitare dhe të sistemit të formimit dhe trajnimit të mësuesve.



7 Vlerësimi

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënësit dhe të nxjerrë në pah rezultatet e tij. Praktikën e vlerësimit kanë ndikim vendimtar në procesin e të nxënësit dhe të mësimdhënies. Çështje të tilla, si: çfarë të dhënash duhet të mbledhim për arritjet e nxënësve, si do t'i mbledhim dhe si do t'i interpretojmë ato, janë dhe duhet të jenë objekt debati në të gjithë komunitetin shkollor.

Mësuesit dhe nxënësit e ngrenë punën e tyre për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e të nxënësit pikërisht duke u bazuar në cilësinë e informacionit që sigurohet nga këto gjykime. Kjo rrit edhe besueshmërinë e vlerësimeve të mësuesve të prindërit, kolegët dhe komuniteti.

Një vlerësim cilësor dhe i paanshëm bazohet në kritere të vlefshme, transparente dhe të zbatueshme. Ky vlerësim i shërben përmirësimit të të nxënësit, atëherë kur procesi ka karakter edukativ dhe motivues dhe mbështetet në kritere të mëposhtme.

Vlefshmëria

Vlerësimi duhet të sigurojë informacion të vlefshëm për idetë, proceset, rezultatet dhe vlerat që priten të ngjizen te nxënësit gjatë procesit të arsimit të tyre në nivele të ndryshme.

Nxënësit dhe mësuesit priren të përqendrojnë përpjekjet e tyre në dijet dhe aftësitë që vlerësohen, pasi në to vihen re edhe ndryshimet që shpesh janë objekt vlerësimi. Për këtë arsye, proceset e vlerësimit duhet të trajtojnë të gjithë gamën e gjerë të objektivave dhe rezultateve të pritshme.

Kriteri arsimor

Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit në rritjen e cilësisë së të nxënësit. Që të luajë këtë rol, vlerësimi:

- duhet të ketë vlerë arsimore në vetvete dhe të jetë pjesë përbërëse e gjithë procesit të të nxënësit;
- duhet të sigurojë informacion të vlefshëm dhe të aftësojë nxënësit të identifikojnë boshllëqet në njohuritë e tyre dhe pasaktësitë në procesin e të menduarit;



- duhet të planifikohet në mënyrë të tillë që të nxisë përdorimin e strategjive afatgjata dhe të efektshme të të nxënit;
- duhet të nxisë të nxënit e pavarur, duke bërë të mundur që nxënësit të marrin përsipër përgjegjësitë për vetëvlerësim.

Transparenca

Nxënësit kanë të drejtë dhe nevojë të njihen me kriteret me të cilat do të vlerësohen. Kjo garanton paanshmërinë e vlerësimit dhe ndihmon të nxënit.

Kriteret e qarta dhe të hapura ndihmojnë gjykimet profesionale, sigurojnë që vendimet të mund të shqyrtohen nga të gjithë dhe të jenë të qëndrueshme.

Paanshmëria

Vlerësimi duhet të jetë i paanshëm për të gjithë nxënësit dhe të mos jetë diskriminues.

Vlerësimi i paanshëm nënkupton vlerësimin e një rezultati të nxëni, duke marrë parasysh karakteristikat dhe rrethanat e çdo nxënësi. Këto karakteristika mund të përfshijnë: gjininë, etninë, gjuhën, racën, rrethanat ekonomike e shoqërore, vendndodhjen, si dhe personalitetin, talentin, aftësitë e kufizuara etj.

Vlerësimi duhet të jetë i ndjeshëm ndaj këtyre ndryshimeve, në mënyrë që nxënësit të mos vihen në situata më pak ose më shumë të favorshme për të treguar arritjet e tyre.

Vlerësim tërësor

Gjykimet për përparimin e nxënësve duhet të bazohen në lloje dhe burime të ndryshme informacioni.

Informacioni i marrë nga vlerësimi duhet të tregojë në mënyrë të besueshme, nëse nxënësi është në gjendje të realizojë atë çfarë përshkruhet në rezultatet e të nxënit.

Integrimi i llojeve dhe burimeve të ndryshme të të dhënave të mbledhura gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe në situata të ndryshme është kusht i domosdoshëm për të siguruar gjykime të qëndrueshme dhe të paanshme për arritjet e nxënësve.



7.1 Sistemet e vlerësimit

Sistemi i vlerësimit synon të mundësojë marrjen e informacionit sa më të plotë e tërësor për arritjet e nxënësit dhe shkallën e zotërimit të kompetencave kyçe.

Ky sistem përfshin:

- a. vlerësimin e brendshëm;
- b. vlerësimin e jashtëm.

7.1.1 Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm realizohet nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollës, në veprimtarinë e përditshme mësimore edukative. Ky lloj vlerësimi u mundëson nxënësve të shprehin nivelin e zotërimit të dijeve, të kompetencave, të vlerave dhe të qëndrimeve, të shprehura përmes rezultateve të të nxënësve. Gjithashtu, përmes këtij vlerësimi, gjykohet rreth aftësisë së nxënësve për të zbatuar të nxënësve në situata dhe rrethana të reja.

Vlerësimi i brendshëm u mundëson mësuesve dhe shkollës që të jenë të saktë dhe të besueshëm në vlerësimin e arritjeve të nxënësve, në të gjitha nivelet e shkollimit të tyre.

Vlerësimi i brendshëm realizohet në:

- nivel klase;
- nivel shkolle.

Vlerësimi i nxënësve në nivel klase i shërben:

- planifikimit të punës së mëtejshme me nxënësit;
- vlerësimit të arritjes të nxënësve;
- identifikimit të prirjeve dhe talentit të nxënësve.

Vlerësimi në nivel klase përfshin **vlerësimin e vazhdueshëm** gjatë gjithë vitit shkollor, **vlerësimin përfundimtar** (me rastin e përfundimit të vitit shkollor) dhe **vlerësimin përmbyllës** (me rastin e përfundimit të shkollës së kurrikulës).

Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve, përveç formave të ndryshme joformale gjatë gjithë procesit mësimor, bëhet nëpërmjet shkallës së vlerësimit që përfshin notat nga 4- 10.



Nota 4: Një arritje që tregon zotërim të pamjaftueshëm të njohurive dhe kompetencave.

Nota 5: Një arritje që tregon zotërim të mjaftueshëm të minimumit të njohurive dhe kompetencave me disa gabime.

Nota 6: Një arritje që tregon zotërim të mirë të minimumit të njohurive dhe kompetencave me shumë pak gabime.

Nota 7: Një arritje që tregon zotërim të kënaqshëm të shumicës së njohurive dhe kompetencave me disa gabime.

Nota 8: Një arritje që tregon zotërim të mirë të njohurive dhe kompetencave, me disa gabime.

Nota 9: Një arritje që tregon zotërim shumë mirë të njohurive dhe kompetencave, me shumë pak gabime.

Nota 10: Një arritje që tregon zotërim të shkëlqyer të njohurive dhe kompetencave me shumë pak ose asnjë gabim.

Vlerësimi përfundimtar bëhet në fund të çdo viti shkollor dhe reflekton nivelin e performancës së nxënësit gjatë një viti shkollor.

Përshkrimi i nivelit të vlerësimit përfundimtar me notë është si vijon:

Nota E: mesatarja e performancës gjatë vitit shkollor në nivelin e vlerësimit 4.00 – 4.49.

Nota D: mesatarja e performancës gjatë vitit shkollor në nivelin e vlerësimit 4.50 – 5.99.

Nota C: mesatarja e performancës gjatë vitit shkollor në nivelin e vlerësimit 6.00 – 7.49.

Nota B: mesatarja e performancës gjatë vitit shkollor në nivelin e vlerësimit 7.50 – 8.99.

Nota A: mesatarja e performancës gjatë vitit shkollor në nivelin e vlerësimit 9.00 – 10.00.

Në fund të vitit shkollor, i cili shënon edhe përfundimin e një shkalle të kurrikulës (klasa II, V, VII, IX, XI dhe XII), përveç vlerësimit përfundimtar, bëhet edhe vlerësimi përmbyllës.

Vlerësimi në nivel shkolle

Vlerësimi në nivel shkolle kryhet nga shkolla me qëllim vetëvlerësimin e cilësisë së procesit edukativo-arsimor që ofrohet në nivel shkolle si dhe për të planifikuar masat që të sigurohet niveli i kompetencave kyçe nga të gjithë nxënësit.



7.1.2 Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i jashtëm i arritjes së nxënësve organizohet nga autoritetet qendrore të arsimit për të njohur dhe/ose verifikuar gjendjen dhe nivelin të cilësisë së arsimit.

Vlerësimi i jashtëm mund të organizohet nga MAS, AKP, ISHA, DAR/ZA etj.

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet:

- për njohjen ose verifikimin e nivelit të arritjeve arsimore në nivel kombëtar, rajonal ose shkolle;
- për vlerësimin e standardizuar të arritjeve të nxënësve në nivel kombëtar;
- për verifikimin e cilësisë së vlerësimit të arsimit në nivel rajoni, shkolle ose klase;
- për qëllime hulumtimi.

Vlerësimet e standardizuara shtetërore organizohen në përfundimin të klasës IX dhe XII.



8 Dokumentet kurrikulare

Dokumentet kurrikulare që e mundësojnë zbatimin e saj në sistemin arsimor, janë:

- Kurrikula e fëmijërisë së hershme (3-6 vjeç);
- Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë;
- Plani mësimor, programet lëndore për shkallë dhe klasë, planet mësimore për fushë dhe lëndë, nga klasa përgatitore deri në klasën XII;
- Tekstet shkollore, materialet plotësuese të mësimdhënies dhe të nxënies, udhëzuesit kurrikularë, si dhe materialet didaktike e instrumentet për vlerësim.

8.1 Kurrikula bërthamë

Kurrikula bërthamë është dokument i rëndësishëm i kurrikulës së arsimit parauniversitar. Ajo miratohet nga MAS-i (për secilin nga tri nivelet arsimore) dhe përmban orientime dhe dispozita të detyrueshme për të gjithë nxënësit.

Çdo kurrikul bërthamë përmban rezultatet e të nxënit sipas fushave dhe shkallëve të kurrikulës.

Rezultatet e të nxënit shprehin pritshmëritë në raport me arritjet konkrete të matshme të nxënësve në fund të çdo shkalle të kurrikulës.

Rezultatet e të nxënit sipas shkallëve të kurrikulës sigurojnë integrimin e fushave të kurrikulës për të zhvilluar kompetencat kyçe.

- *Rezultatet e të nxënit sipas shkallëve të kurrikulës* parashikohen të arrihen në përfundim të shkallës. Ato paraqesin kushtin për kalimin nga një nivel shkollimi në tjetrin.

Hierarkia e dokumenteve kurrikulare	Sistemi i rezultateve të të nxënit
Korniza Kurrikulare	Rezultatet kryesore të të nxënit që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritjes së kompetencave kyçe, pas përfundimit të arsimit parauniversitar.



Kurrikula bërthamë për shkallët e kurrikulës 1-6	Rezultatet e të nxënit që shprehin nivelin e domosdoshëm të arritjes së kompetencave kyçe, pas përfundimit çdo shkalle të kurrikulës.
Planet e programet lëndore	Rezultatet e të nxënit që arrihen në çdo lëndë, në secilën klasë.

Rezultatet e të nxënit sipas shkallëve të kurrikulës

Rezultatet e të nxënit të shkallëve të kurrikulës shprehin kërkesat themelore për të zotëruar kompetencat kyçe në përfundim të një shkalle të caktuar të kurrikulës. Ato paraqesin atë që nxënësit duhet të dinë dhe të bëjnë pas përfundimit të një shkalle të kurrikulës dhe paraqesin kushtin për kalimin nga një nivel arsimor në tjetrin.

Rezultatet e të nxënit sipas fushave të të nxënit

Rezultatet e të nxënit për fushat e të nxënit:

- *Rezultatet e të nxënit sipas fushave të të nxënit*, sigurojnë lidhjen ndërmjet lëndëve dhe veprimtarive mësimore për integrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve nëpërmjet mësimin të integruar të lëndëve. Ato nxisin qasje të bazuar në kompetenca dhe shërbejnë si pikënisje për hartimin e planeve dhe programeve lëndore, si dhe integrojnë lëndët dhe veprimtaritë mësimore të një fushe të nxëni.

8.2 Plani mësimor dhe programet sipas lëndëve

Plani mësimor është dokument zyrtar i rëndësishëm i politikës arsimore. Në planin mësimor përcaktohen fushat e të nxënit, lëndët dhe shpërndarja e kohës mësimore. Hartuesit e planit mësimor sigurojnë që plani mësimor:

- mundëson realizimin e parimeve dhe synimeve arsimore të përshkruara në Kornizën Kurrikulare;
- ruan baraspeshën ndërmjet traditës pozitive dhe risive rajonale dhe/ose botërore;
- siguron koherencën kurrikulare vertikale dhe horizontale të kurrikulës.

Krahas rezultateve të të nxënit, programet lëndore përmbajnë:

- njësitë tematike mësimore;



- udhëzimet metodike për realizimin e njësive tematike/mësimore;
- mundësitë e organizimit të përvojave mësimore gjatë një viti shkollor;
- materialet didaktike, burimet dhe mjetet ndihmëse.

Të gjitha dokumentet e kurrikulës hartohen në përputhje me parimet themelore të saj.

8.3 Udhëzuesit kurrikularë

Udhëzuesit kurrikularë ndihmojnë në zbatimin e unifikuar të politikës kurrikulare në të gjitha fazat e zbatimit të saj.



Fjalorth i terminologjisë kurrikulare

TERMAT	SHPJEGIMI
Aftësi	Kapacitet i lindur ose i fituar që e lejon personin të ndërtojë njohuri, për të vepruar me sukses në situata të caktuara.
Arsim	Veprimtari themelore e institucioneve arsimore që siguron krijimin dhe shndërrimin e njohurive; përsosjen e kompetencave gjatë gjithë jetës; zhvillimin vetjak; zhvillimin dhe shndërrimin e kulturës. Rezultat i nxënies së qëllimshme, të planifikuar dhe të organizuar në mënyrë formale dhe joformale.
Arsim formal	Arsim i qëllimshëm, i institucionalizuar, i planifikuar, i strukturuar në mënyrë hierarkike, që fillon me arsimin parashkollor dhe vazhdon deri në arsimin pasuniversitar. Rezultatet dhe kualifikimet e fituara në arsimin formal njihen nëpërmjet certifikatave dhe diplomave.
Arsim joformal	Arsim i qëllimshëm, i planifikuar, i institucionalizuar, alternativ dhe plotësues i arsimit formal, në kuadër të të nxënies gjatë gjithë jetës. Arsimi joformal mund zhvillohet brenda ose jashtë institucioneve arsimore dhe iu shërben personave të të gjitha moshave. Për programet e arsimit joformal mund të jepet ose jo certifikatë, e cila nuk është e barasvlershme me kualifikimet formale.
Arsim i detyrueshëm	(shih: <i>Arsim bazë</i>)
Arsim bazë	Tërësia e njohurive dhe kompetencave që duhet të zotërojë nxënësi deri në fund të klasës së nëntë. Kohëzgjatje e shkollimit që konsiderohet si e detyrueshme me ligj. Arsimi bazë në Shqipëri përfshin arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (KSNA 1 dhe 2).
Arsim parashkollor	Nivel i arsimit me kodin 0 (KSNA 0).
Arsim fillor	Nivel i parë i arsimit me kohëzgjatje prej pesë vitesh (KSNA 1).
Arsim i mesëm	Nivel i dytë dhe i tretë i arsimit me kohëzgjatje prej shtatë vitesh (KSNA 2, 3).
Arsim i mesëm i ulët	Nivel i dytë i arsimit me kohëzgjatje prej katër vitesh (KSNA 2).
Arsim i mesëm i lartë	Nivel i arsimit me kohëzgjatje prej tri vitesh (KSNA 3).
Arsim profesional	Arsim që iu mundëson nxënësve zhvillimin e kompetencave për punë dhe kualifikime profesionale për profesione të caktuara.
Autonomi e shkollës	E drejtë e garantuar që i jepet shkollës për të vendosur për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle, për menaxhimin e burimeve njerëzore në dispozicion të saj dhe në disa raste, edhe për menaxhimin e burimeve financiare.
Burim i të nxënies	Çdo burim i cili mbështet drejtpërdrejt ose tërthorazi, të nxënies. Burimet janë të brendshme (njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera, qëndrime etj.)



	dhe të jashtme (dijet e kodifikuara në tekste, mjetet didaktike, mësuesit, shoqëria etj.).
Ciklet/nivelet /shkallët e kurrikulës	Një mënyrë e organizimit të kurrikulës në blloqe vitesh shkollore. Ciklet/nivelet/shkallët e kurrikulës përcaktojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe rezultatet e të nxënimit brenda çdo cikli, në përshtatje me moshën e nxënësve. Ciklet/ nivelet/shkallët e kurrikulës, jo domosdoshmërisht përkrijnë me nivelet arsimore formale.
Dije	E vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kriterëve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollore apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo prakticienëve. Dija është shoqërore.
Ekonomi dhe shoqëri e dijes	Ekonomi dhe shoqëri në të cilën dija bëhet burimi kryesor i zhvillimit dhe përparimit.
Fushë e të nxënimit	Një bashkësi lëndësh që kanë qëllime dhe detyra të përbashkëta për formimin e njohurive të reja dhe kompetencave.
Integrim kurrikular	Proces i ndërthurjes së përmbajtjeve mësimore dhe metodave, me qëllim që të sigurohet të nxënimit sistemik dhe tërësor.
Njohuri	Ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetëreflektimi për t' u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij. Njohuria është vetjake.
Kompetencë	Harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.
Kompetencë kyçe	Kompetenca për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje sociale dhe për punësim.
Kornizë kurrikulare	Kornizë kurrikulare është dokumenti themelor në të cilin përshkruhen orientimet dhe udhëzimet kryesore për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar (qëllimet e arsimit, kompetencat kyçe, rezultatet e të nxënimit sipas niveleve etj.).
Kurrikul	Sistemi i përbërë nga disa elemente me synime arsimore që, të lidhura mes tyre, lejojnë të orientohet dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula bazohet në realitete historike, shoqërore, gjuhësore, politike, fetare, gjeografike dhe kulturore të një vendi. Me anë të saj sigurohet arsimim cilësor dhe i barabar për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore dhe ndryshime të tjera.
Kurrikul bërthamë	Kurrikul e përbashkët për të gjithë nxënësit e një niveli në sistemin arsimor.
Kurrikul e përvetësuar	Tërësi e rezultateve të të nxënimit që zotëron nxënësi.
Kurrikul e zbatuar	Kurrikul e analizuar, interpretuar dhe zhvilluar në institucionet arsimore dhe e mbartur te nxënësi, sipas udhëzimeve themelore të kurrikulës.
Kurrikul formale/ e planifikuar	Kurrikul që përmban udhëzimet themelore kurrikulare, të përcaktuara në nivelin qendror të vendimarrjes arsimore (kornizë kurrikulare, programe



	mësimore, tekste etj.). Kurrikula formale shërben si bazë për dhënien e dëftesave, diplomave dhe certifikatave të njohura me ligj.
Kurrikul në bazë shkolle	Kurrikul që përgatitet dhe zbatohet në nivel shkolle.
Kurrikul me zgjedhje	Pjesë e kurrikulës që përfaqëson lëndë dhe veprimtari kurrikulare që përmbushin nevojat dhe interesat e nxënësve, të vendosura në nivel shkollë.
Kurrikul me bazë kompetencat	Kurrikul që siguron zhvendosjen e fokusit të nxënies nga përmbajtjet lëndore (mësuesi në qendër) në atë që nxënësit kanë nevojë të dinë dhe të bëjnë me efikasitet në situata të ndryshme (nxënësi në qendër).
Koherencë e kurrikulës	Karakteristikë e kurrikulës që tregon se në ç' masë synimet e kurrikulës, përmbajtjet mësimore, strategjitë e të nxënësve dhe vlerësimit janë të integruara dhe përforcojnë njëra-tjetrën.
Konstruktivizëm	Teori e të nxënësve që bazohet në parimin se personi e ndërton njohurinë në mënyrë aktive duke ndërvepruar me mjedisin dhe shoqërinë.
Lëndë	Degë e dijes e organizuar në mënyrë të qëllimshme, si një disiplinë e veçantë e të nxënësve që mësohet në një ose disa nivele arsimore dhe krijon kushte për ndërtimin e njohurive të reja dhe kompetencave kyçe nga nxënësit.
Llogaridhënie dhe përgjegjshmëri	Proces në të cilin aktorët njohin, marrin përgjegjësi dhe japin llogari për vendimet, veprimet dhe pasojat e tyre. Llogaridhënia është e rëndësishme sidomos në kontekstin e decentralizimit të sistemit arsimor, i cili nxit autonominë shkollore, duke përfshirë edhe vendimet në lidhje me kurrikulën.
Metodologji e vlerësimit	Strategji dhe veprimtari të zbatuara për të matur arritjet e nxënësve.
Mësimdhënie	Proces i planifikimit, i organizimit dhe i udhëheqjes së situatave të të nxënësve (formale ose joformale) nga mësuesi.
Mësimdhënie dhe nxënie ndërvepruese	Filozofia dhe praktika e përfshirjes së nxënësve në procesin mësimor, duke i inkurajuar ata të sjellin përvojën dhe njohuritë e tyre në këtë proces (duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e tyre), me qëllim zhvillimin e kompetencave.
Mësimdhënie e diferencuar	Mësimdhënie që plotëson nevojat e nxënësve nëpërmjet përvojave të ndryshme të të nxënësve.
Mësimdhënie për njëri-tjetrin	Një praktikë në të cilën mësuesit dhe nxënësit ndajnë njohuritë e shkathtësitë e tyre dhe mbështesin të nxënësve të njëri-tjetrit.
Mjedis miqësor për fëmijët	Një mjedis arsimor i sigurt, gjithëpërfshirës, i shëndetshëm që bazohet në të drejtat e fëmijëve.
Mundësi për të nxënë	Situata dhe procese që sigurojnë kushtet dhe mjedisin për nxitjen e të mësuarit tek nxënësit .
Nivel arritjeje	Një deklaratë që përcakton masën në të cilën është arritur rezultati i të nxënësve ose niveli i njohurive dhe kompetencave kyçe.
Orientim për karrierë	Shërbime dhe veprimtari që mbështesin individët e çdo moshe dhe në çdo moment përgjatë jetës së tyre, për të bërë zgjedhje në lidhje me arsimin, trajnimin, profesionin dhe për të menaxhuar karrierën e tyre.



Përmbajtje mësimore	Tërësia e dijeve, informacionit, fakteve, situatave, veprimtarive etj., të grupuara në një lëndë ose fushë të nxëni, që shërbejnë si bazë për formimin dhe zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave kyçe.
Përvojat e të nxënit	Kushtet dhe situatat e të nxënit që u ofrohen nxënësve për ndërtimin e njohurive të reja dhe kompetencave kyçe.
Politikë kurrikulare	Vendime, udhëzime dhe orientime formale, të marra nga qeveria apo autoritetet arsimore për hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës.
Program mësimor	Dokument që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënit, metodologjitë e të nxënit dhe vlerësimit për një lëndë të caktuar.
Qasje me në qendër fëmijën / Qasje e bazuar në kompetenca	Qasje që synon dhe krijon kushte që përmbajtja e nxënies dhe veprimtaritë mësimore t'i shërbejnë formimit dhe zhvillimit të njohurive të reja dhe kompetencave kyçe të personit (grupit të personave), nëpërmjet ndërveprimit me situatat në kontekst.
Qëndrim	Përgatitje ose gatishmëri për të përballuar e për të trajtuar sfidat dhe detyrat në një mënyrë të caktuar. Qëndrimet ndikohen nga njohuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore).
Rezultat i të nxënit	Termi ka kuptim të dyfishtë. Së pari, është deklarata që përshkruan atë se çfarë duhet të dinë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë si duhet nxënësit. Së dyti, u referohet njohurive të reja, kompetencave etj., që ndërton dhe përsos personi/grupi, pasi përmyll nivelin arsimor. Rezultati i të nxënit është koncept kyç për hartimin e mjeteve që mundësojnë transparencën, krahasimin, transferimin dhe njohjen e kualifikimeve në mes vendeve të ndryshme, në nivele të ndryshme.
Stile të nxëni	Një grup i sjelljeve dhe qëndrimeve që ndikojnë në mënyrën se si nxënësit mësojnë dhe bashkëveprojnë me mësuesit dhe shokët. Stilet e të mësuarit janë njohëse, emocionale dhe sjellje fiziologjike që shërbejnë si tregues se si nxënësit perceptojnë, ndërveprojnë dhe i përgjigjen mjedisit të të nxënit. Një individ mund të ketë disa stile të nxëni të cilat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në përputhje me detyrën.
Standard	Nivel i arritjes apo suksesit që pritet të arrihet prej nxënësve.
Strukturë e kurrikulës	<i>Struktura e kurrikulës shprehet në Kornizën Kurrikulare.</i>
Shpërndarja e kohës mësimore	Kohët e caktuara për nxënie, lëndë të veçanta, fusha të nxëni apo veprimtari të tjera plotësuese, gjatë një intervali të caktuar kohor (ore mësimi, jave shkollore, vit mësimor) sipas rregulloreve, kërkesave dhe rekomandimeve zyrtare.
Shkathtësi	Kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës ose energjisë, ose të të dyjave. Shkathtësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë.
Tema ndërkurrikulare	Tema madhore me të cilat përballet shoqëria dhe zhvillohen në fushat e të nxënit. Të tilla janë: identiteti kombëtar, qytetaria aktive, çështje gjinore,



	siguria dhe shëndeti mendor e fizik, zhvillimi i qëndrueshëm etj.
Të nxënimit	Proces i motivuar dhe i qëllimshëm me karakter vetjak ose shoqëror, i ndërtimit të njohurive të reja, kompetencave etj., nga personi nëpërmjet reflektimit vetjak, rindërtimit dhe ndërveprimit shoqëror. Zhvillohet në mjedise formale, joformale dhe informale.
Të nxënimit e nxënësve nga njëri-tjetri	Proces i të nxënimit që bazohet në shkëmbimin e informacionit dhe përvojave ndërmjet nxënësve dhe që pasuron të nxënimit.
Të nxënimit sistemik	Një qasje që synon të aktivizojë të gjitha aspektet e vetjake të nxënësve (intelektin, emocionet, imagjinatën, trupin) për një të nxënë tërësor efektiv.
Të nxënimit ndërveprues	Proces nëpërmjet të cilit nxënësit me nivele të ndryshme arritjeje punojnë së bashku në grupe të vogla, për një qëllim të përbashkët.
Të nxënimit nëpërmjet TIK-ut	Forma të të nxënimit formal dhe joformal nëpërmjet përdorimit të TIK-ut, të rëndësishme për të nxënimit gjatë gjithë jetës, si dhe për edukimin në distancë.
Të nxënimit gjatë gjithë jetës	Të nxënimit që realizohet gjatë gjithë jetës mbi bazën e njohurive, kompetencave kyçe dhe kualifikimeve, dhe që i zhvillon ato më tej për qëllime vetjake, profesionale dhe shoqërore.
Teknologjitë e informimit dhe komunikimit (TIK)	Një tërësi mjetesh dhe burimesh teknologjike të cilat përdoren për të transmetuar, mbledhur, krijuar dhe shkëmbyer informacion. Këto mjete dhe burime teknologjike përfshijnë kompjuterët, internetin apo pajisje të tjera digjitale.
Vlerë	Bindje që ruhet thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme. Ajo shprehet nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave.
Veprimtari plotësues kurrikulare	Veprimtari të strukturuar mësimore, të qëllimshme që ndodhin jashtë kontekstit të lëndëve dhe fushave të të nxënimit. Këto veprimtari mund të përfshijnë projektet, sportet, punën vullnetare, fotografimin, dramën, muzikën etj.
Veprimtari përmirësues	Veprimtari ose programe që synojnë të ndihmojnë nxënësit me vështirësi në të nxënë. Nëpërmjet tyre nxënësit tejkalojnë vështirësitë në të nxënë në mënyrë efektive.
Vetëvlerësim i të nxënimit	Vlerësim nga i cili nxënësi mbledh informacion dhe reflekton rreth të nxënimit e tij; gjykon për të në raport me objektivat dhe kriteret e vendosura; identifikon përparësitë e dobësitë dhe i përmirëson në përputhje me rrethanat. Është vlerësimi që bën nxënësi për progresin e tij bazuar në njohuritë e reja dhe kompetencat kyçe.
Vlerësim në arsim	Proces nëpërmjet të cilit matet ose gjykohet përparimi (progresi) dhe nivelet e arritjeve të nxënësve, në përputhje me kriteret specifike të cilësisë.
Vlerësim diagnostikues	Vlerësim që identifikon nivelet e arritjeve të nxënësve, për të orientuar mësimin drejt plotësimit nevojave të tyre për nxënë.
Vlerësimi gjatë nxënies	Vlerësim i kryer gjatë gjithë procesit mësimor me qëllim nxitjen e procesit të të nxënimit. Ky vlerësim formues e sheh të nxënimit si proces e jo vetëm si



	rezultat.
Vlerësim i jashtëm	Një proces dhe metodë vlerësimi që e zhvillon dhe e përdor një agjenci apo organ vlerësues (jo shkolla). Ky proces zakonisht përfshin testimin e standardizuar, dhe shpesh shërben për të klasifikuar kandidatët për mundësitë e mëtejshme arsimore dhe për qëllime certifikimi.
Vlerësim i të nxënësve	Vlerësim i arritjeve të nxënësve për të siguruar informacion në lidhje me progresin e tyre (arritjet e tyre në fusha të ndryshme të kurrikulës /lëndëve mësimore dhe zotërimin e kompetencave kryesore). Ky proces shpesh përfshin përdorimin e testeve të standardizuara dhe përdoret për qëllime promovimi ose diplomimi.
Vlerësim përmbljedhës	Vlerësim që përmbledh përparimin dhe arritjet e nxënësve në fund të një viti mësimor apo të një cikli.
Vlerësim i nxënësve për njëri-tjetrin	Vlerësim i punës ose i detyrës së një nxënësi nga nxënës të tjerë.
Vlerësim i portofolit të nxënësve	Vlerësim i koleksionit të detyrave të nxënësve (detyra ose punë me shkrim, drafte, punë artistike, prezantime) të cilat pasqyrojnë njohuritë e reja dhe kompetencat e nxënësve.
Zbatim i kurrikulës formale	Proces i përdorimit të kurrikulës formale në shkollë që përfshin zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulës në shkollë, udhëheqjen e shkollës, trajnimin e mësuesve në shërbim, përgatitjen e teksteve të reja, materialeve dhe burimeve të të nxënësve, si dhe të udhëzuesve.
Zhvillim i kurrikulës	Cikli i plotë i planifikimit, i hartimit, i zbatimit, i vlerësimit dhe rishikimit për të siguruar që kurrikula është e përshtatshme dhe e përditësuar.